

Abdi Baleta

Kush dhe çfarë fshihet pas termit

KOMUNIZËM ISLAMIK



KUSH DHE ÇFARË FSHIHET PAS TRILLIMIT

“KOMUNIZËM ISLAMIK”?

Abdi Baleta

KUSH DHE ÇFARË FSHIHET PAS TRILLIMIT "KOMUNIZËM ISLAMIK"?

Nga të gjitha trillimet që janë përhapur para pak muajsh në organin e Partisë Demokristiane, **"Ora e Shqipërisë"** për të bërë fushatë kundër nacionalizmit dhe myslimanizmit në Shqipëri më djallëzori është ai për *"feudo-komunizmin shqiptar islamik"*

Mark Bregu më datën 6 prill 2001 ka renditur pa marifet një sërë të pavërtetash kundër Islamit e myslimanëve të Shqipërisë dhe mbi të gjitha ka lëshuar disa fallsifikime marroqe për përhapjen dhe përhapësit e komunizmit në Shqipëri për të argumentuar se Shqipëria komunizmin e llojit më të keq në botë e paska patur peshqesh nga myslimanizmi.

Nuk kishim ndeshur më parë kësi përçartje ethesh anti-islamike sa në shkrimin e Mark Bregut që ky e fillon me pohimin hileqar: *"Nuk mund t'ia faturojmë komunizmit të gjitha të këqijat"*, sikur të kishte për të shpjeguar rënien aksidentale të zjarrit nga një qark i shkurtër elektrik pas një lidhjeje të keqe telash.

Për fanatikët katolikë Islami më i rrezikshëm se komunizmi

Në mjaft raste ka rënë në sy se disa klerikëve e besimtarëve katolikë të fanatizuar nuk u ben zemra ta luftojnë pa kompromis komunizmin, ndonëse nëpër gazeta e libra vazhdojnë shkrimet e vlerësimet, mbase të tepëruara, se katolicizmi dhe kleri katolik kanë qënë viktimat më të persekutuar nga komunizmi në Shqipëri.

"Ora e Shqipërisë" na jep provën se në shtratin e fanatizmit katolik tani janë shtrirë njerëz që dhimbjet nga "sëmundja e komunizmit" i quajnë gati të kapërcyera dhe paskan nevojë të kurohen nga disa dhimbje më të forta që i bëjnë të ulërijnë kundër myslimanizmit.

Mark Bregu në çastet kur i janë qetësuar dridhjet e etheve të tij paska bërë "diagnozën" e dhimbjeve: *"Komunizmi është pasoja, ndërsa shkaku duhet të jetë shtrati islamik që ai gjeti në Shqipëri"*. Pra, për Mark Bregun, komunizmi asnjëherë në Shqipëri nuk paska qenë burim të këqijash, por vetëm një e keqe me burim tjetër, që sipas Markut duhet të jetë *"shtrati islamik"*.

Nga këta rreshta që u cituan duket që shtratin e tij të fanatizmit katolik Marku ka marrë jermi. Ai nuk i referohet ndonjë autoriteti tjetër, përveç vehtes, që ta provojë një hipotezë të tillë. Markut i mjafton jermi i vet anti-islamistik prej të padituri, si dhe ndonjë trillim bajat që i servirin ata që përpunojnë në laboratore të fshehura luftën teoriko-psikologjike kundër Islamit.

Me kallogjerë politikë, ekzibicionistë të fanatizmit katolik, si Marku dhe gazeta pa vlerë si **"Ora e Shqipërisë"** dikush përpigjet të shpërndajë *"formularë indulgjence"* për mekatet e komunizmit në Shqipëri. (Induljencia janë quajtur disa fletë që i shiste kisha katolike me anën e të cilave Papa ia falte mëkatet blerësit).

Për ta bërë sa më të besueshme indulgjencën për mëkatet e komunizmit në Shqipëri, Marku dhe **"Ora e Shqipërisë"** kanë vazhduar: *"Pikërisht ky favor (d.m.th shtrati islamik) bani që komunizmi shqiptar të ishte ma i egri dhe i shëmtuari nga gjithë vendet e Lindjes"*. Marku ndërton dordolecin më të shëmtuar për *"komunizmin shqiptar"*, e paraqet atë si një shpërftytirim edhe të vetë komunizmit standart, sepse i duhet të përforcojë idenë e tij dhe të frymëzuesve të tij se varianti më i keq, më i rrezikshëm në botë është ai i "komunizmit islamik" që në praktikë paska vetëm një shëmbull konkret, "komunizmin shqiptar".

Fanatikët katolikë shfajësojnë sllavo-komunizmin

Deri tani askush nuk kishte guxuar të merrte kaq habdallçe mbi supe barrën e rëndë për t'u dhënë udhë problemeve të tilla teorike.

Është pak enigmatike pse kjo kjo punë i mbeti një elektrici në pension në Shkodër dhe pse nëpërmjet një gazete të rëndomtë si **“Ora e Shqipërisë”**! Por përderisa ka kërkuar meritën e trajtimit publik të çështjes **“Ora e Shqipërisë”** duhet të mbajë në kurriz edhe përgjegjësinë për sfidat që ka bërë ndaj të vërtetës, ndaj Islamit dhe ndaj myslimanëve të Shqipërisë.

Marrëzitet edhe kur janë të përmasave të mëdha nuk barazohen me guximin në fushën e mendimit e të analizës teorike. Nuk ka asnjë fije guximi mendimi në shtjellimet marroqe të **“Orës së Shqipërisë”** se : *“pa dyshim këtë ideologji (komunizmin) nuk e sollën as Gjergjat, as Frrokat, as Nikollat. Në Jug atë e sollën Halim Xhelo e Riza Cerova, ndërsa në Veri e sollti militanti i shquar Ali Kelmendi. Zef Malaj, Tuk Jakova, Gjovalin Luka e Mark Ndoja (në Veri) dhe Sejfulla Malëshova, Lllazar Fundo, Koço Tashko (në Jug) kishin pikëpamje social-demokrate dhe liberale e u asgjësuan nga Enver Hoxha, Mehmet Shehu, Manush Myftiu. Mendoj se mjafton ky fakt për të vërtetuar se në Shqipëri asnjëherë nuk ka mbizotëruar komunizmi sllavo- ortodoks, por feudo-komunizmi i dalun nga inkubatori islamiko-bizantin. Në Partinë e Punës ortodoksët kanë mbajtur çelsat e kashtës”*.

Jo vetëm ai **“çerek-fakt”** që ka përmendur Marku, por as **“brigje”** të tëra me **“fakte”** si ai nuk vërtetojnë dot atë që kërkon Marku dhe sidomos nuk maskojnë dot atë që ka marrë përsipër të fshehtë **“Ora e Shqipërisë”** për gjëmat e të zezat që Shqipërisë ia solli dhe po ia sjell sllavo-komunizmi ortodoks.

Përsa i përket peshës së madhe specifike që kanë patur në Partinë e Punës hierarkët e militantët me prejardhje fetare ortodokse, sidomos vllahët, grekofonët e sllavët nuk kam përse të ndalem gjatë, sepse kjo dukuri është analizuar e shpjeguar në mënyrë të plotë e bindëse në librin e kolegut tim Hysmadin Feraj **“Skicë e mendimit politik shqiptar”** (“Koha”, Tiranë 1998), të cilën me siguri Mark Bregu nuk e ka lexuar dhe nuk mund ta lexojë edhe për urrejtjen ndaj autorit, edhe për paaftësinë intelektuale që të kuptojë dhe të shijojë një vepër të tillë shkencore.

Frazat e sipërcituara nga shkrimi i Mark Bregut në fillim të bëjnë të gajasesh, por një vështrim më i kujdesshëm të nxjerr para syve një dëshmi të një politike dhe strategjie mashtruese dhe provokuese ndaj shqiptarëve, për të shfajësuar në sytë e tyre komunizmin sllavo-ortodoks dhe për të nxitur një luftë politiko-ideore të pakuptimtë e të rrezikshme për Shqipërinë kundër myslimanizmit.

Këtu qëndron arsyeja kryesore që detyrohemi të merremi në mënyrë të posaçme me këtë pjesë të shkrimit të Mark Bregut dhe me këtë mision politiko-fetar me rrjedhoja shumë të dëmshme që ka pranuar të përmbushë Partia Demokristiane nëpërmjet organit të saj **“Ora e Shqipërisë”**.

Në këto që cituam më sipër, ka pra mjaft material për t'u zbavit e për t'u neverit. Por le të merremi me aspektet serioze të problemeve që përpiket t'i shpërfytyrojë e fallsifikojë **“Ora e Shqipërisë”**.

PDK dhe organi i saj synojnë :

-Të rehabilitojnë deri në njëfarë mase komunizmin në përgjithësi dhe sllavo-komunizmin në veçanti që janë bërë të urreyer dhe të diskredituar në sytë e shumicës së shqiptarëve.

-Të sajojnë një variant të veçantë, më të keqin, të komunizmit duke e cilësuar si **“komunizëm shqiptar”**

-Ta veçojnë këtë komunizëm nga teoria dhe praktika e përgjithshme e komunizmit duke e shpallur si **“komunizëm specifik”** të lindur e të zhvilluar mbi **“Shtrat islamik”**

-Ta paraqesin Islamin si fenë që prodhuaka variantin më të keq të komunizmit në botë

-Ta fallsifikojnë procesin e fillimit, përhapjes, e sundimit të komunizmit në Shqipëri

-Të fajësohen vetëm shqiptarët e besimit islam për sjelljen dhe vendosjen e komunizmit në Shqipëri. Pra, urrejtjes e luftës kundër komunizmit në gjirin e shoqërisë shqiptare duan t'i japin drejtimin dhe natyrën e një urrejtjeje dhe lufte fetare, të ngrenë të krishterët në bllok kundër myslimanëve dhe për çështje ideologjike e politike

-Të fshehin të vërtetat historike se edhe elementë me prejardhje fetare të krishterë kanë qënë protagonistë të sjelljes e përhapjes së komunizmit në Shqipëri, madje ka patur shumë më tepër të krishterë protagonistë të komunizmit se sa pesha specifike e të krishterëve në popullsinë e Shqipërisë. Të fshihet fakti se shqiptarë të krishterë ishin ata që bënë më shumë për përhapjen e komunizmit në vendin tonë e midis shqiptarëve në përgjithësi.

-Të fallsifikohet e vërteta mbi rolin që kanë luajtur sllavët, grekët, dhe të tjerë nga Europa e krishterë për të futur, përhapur e vendosur sundimin e komunizmit në Shqipëri

-Të fallsifikohet edhe në emër të luftës kundër "*komunizmit islamik*" aleanca që ka bërë e don të forcojnë tani një pjesë e hierarkisë kishtare katolike dhe e fundamentalizmit katolik me Janullatosin dhe kishën ortodokse greke për luftën kundër Islamit në Shqipëri dhe për konvertimin e myslimanëve shqiptarë në të krishterë

-Të përçojnë idenë se vetëm shqiptarët e besimit katolik (ose të krishterët në përgjithësi) kanë të drejtën dhe aftësitë të vihen në krye të procesit të integritetit të Shqipërisë në Europë, pra të mbizotërojnë politikisht në Shqipëri.

-Të ngrenë pengesa të reja për marrëdhëniet e Shqipërisë e të kombit shqiptar me vëndet ku popullsia është kryesisht e besimit islamik.

-Të mbështesin edhe propogandën shoviniste sllavo-greke se prania e një kombi me shumicë popullsie të besimit islam në Ballkan është rrezik për këtë rajon edhe për tërë Europën, sepse qënka burim potencial i rishfaqjes së variantit më të egër, më shkatërrues të komunizmit.

Jam i vetëdijshëm se do të gjenden njerëz që do të më qortojnë me fjalë ose me mendje "pse i stërhollon kaq shumë gjërat duke u nisur nga disa marrëzira që i është shkrepur njëfarë Mark Bregut të shkruajë në "**Ora e Shqipërisë**" dhe kjo gazetë i ka botuar mbase sa për sensacion". Do të ketë edhe dashamirë që do të më thonë: "nuk të shkon ty të humbasësh kohë me llogjet e një fanatiku që nuk mban as ndonjë përgjegjësi etike e intelektuale për ato që shkruan; sepse është një kurrkush në fushën e mendimit e debatit politik". Edhe unë do të bashkohesha me këta qortues e dashamirë, sikur të mos isha i njohur me disa fakte të tjera që më bindin se për fat të keq nuk kemi të bëjmë vetëm me përçartje të shkaktuara nga një fanatizëm i tejskajshëm katolik, por edhe me synime e veprime politike të llogaritura e të studiuar në shkallë më të gjerë, brenda e sidomos jashtë Shqipërisë, nga njerëz që janë shumë më të zgjuar e të përgatitur se Marku.

Kuptohet që Marku është vetëm një zëdhënës tezash politiko-ideologjike që i kanë përpunuar e hedhur para tij të tjerë në Paris, Zagreb, Romë, Athinë, Beograd, Amerikë etj. Por megjithatë e vlen dhe është punë serioze të polemizohet me "**Ora e Shqipërisë**" e me Markun, sepse kjo i shërben mbrojtjes të të vërtetës dhe të interesave të Shqipërisë.

Europa e krishterë djepi dhe bastioni i totalitarizmit modern

Në pamje të parë ato që ka shkruar Mark Bregu për "*komunizmin shqiptar të dalë nga inkubatori islamiko-bizantin*" ngjajnë si një punë tuafi, si tentativë për të shpikur një rrymë të re elektrike, pas asaj që zbuluan e vunë në përdorim Volta, Galvani, Faradei.

Por në shkencat shoqërore punët ngatërrohen më lehtë dhe vemja e konfuzionit përhapet shpejt, sepse nuk përdoren po ato njësi dhe metoda eksperimentimi e demonstrimi si në shkencat ekzakte dhe teknike. Për këtë arsye asnjë "alkimi idesh" nuk duhet lënë jashtë vemendjes e kritikës.

Mark Bregu dhe të tjerë, shumë më të zgjuar se ai që sajojnë "komunizmin islamik" të shqiptarëve, nuk do të jenë në gjendje të provojnë se komunizmi në përgjithësi ka ndonjë lidhje me ndonjë "shtrat" ose komb islamik, si në lindje dhe në vdekjen e tij si sistem politik.

Askush nuk do të arrijë të hedhë poshtë se komunizmi është ideologji dhe praktikë totalitare që ka lindur dhe është forcuar e përhapur mbi shtratin e ateizmit e jo të doktrinë fetare, ndonëse ka huazuar shumë nga liturgia, ritet, ritualet, simbolika, idolatria dhe ikonografia e krishterë.

Jo Mark Bregu, por askush nuk mund të mohojë se dy format më të reja ideologjike e praktike të totalitarizmit të tmerrshëm, të shekullit XX, fashizmi e komunizmi, kanë lindur dhe janë vënë në jetë në vendet europiane, që i përkasin besimit të krishterë, katolik dhe ortodoks.

Më pak se të gjithë vendet e tjera jashtë Europës nga fashizmi dhe nga komunizmi u infektuan vendet islamike. Vetëm Indonezia deri në vitin 1965 ishte e rrezikuar nga mundësia e ardhjes së komunizmit në pushtet. Edhe kjo ndodhte për shkak të ndikimit të madh të Kinës komuniste, sidomos nëpërmjet popullsisë kineze të vendosur në Indonezi. Kurse në vendet e tjera islamike lopata e komunizmit mori fare pak ujë. Del pra që shoqëritë e besimit islam kanë qenë më të imunizuara ndaj dy varianteve të totalitarizmit modern, fashist dhe komunist, se shoqëritë e mbështetura në fe të tjera monoteiste.

Që lexuesit ta marrin më seriozisht këtë vlerësim po përmend se historiani britanik Kliv Ponting në "Historia Botërore", Londër 2000, faqe 764-768 ka shpjeguar se djepi dhe shtrati i fashizmit është Europa e krishterë. Ai thekson se : "Fashizmi ishte e vetmja risi e madhe e ideologjike që u shfaq në shekullin e XX (fq.765)". Ai e përshkruan fashizmin si "anti-liberal, anti-komunist dhe në shumë drejtime anti-konservator". Edhe më me rëndësi në kuadër të kësaj polemike është se Ponting thekson: "Fashizmi ishte i rrënjësuar thellë në traditën europiane dhe kombinonte elemente që formojnë rrymën kryesore të ideve europiane. Nga Franca revolucionare mori idetë e mobilizimit të masave, nga historia e shekullit XX mori vënien e nacionalizmit në epiqendër. Këto u kombinuan me darvinizëm shoqëror që e vë theksin në mbijetesën e më të aftit...."

Krishterimi katolik lindi antisemitizmin

Dihet se racizmi u bë tipar thelbësor i politikës naziste dhe shfaqjen më të egër e gjeti në antisemitizmin hitlerian që çoi në zhdukjen e miliona çifutëve, duke acaruar një plagë të vjetër të historisë së njerëzimit të shkakuar nga "Rikonkuista Spanjolle" dhe pogromet antiçifute në Rusi e në vende të tjera.

Pra tiparet më të shëmtuara të totalitarizmit janë shfaqur herët. Kliv Ponting përmend (në fq.414-415) se "tre shekujt e parë pas vitit 1000 ishin veçanërisht të rëndësishëm për procesin e përcaktimit të një krishterimi të veçantë latin, perëndimor.... Në shekullin XI pati ashpërsim të konflikteve midis kishave latine e greke, veçanërisht në Ballkanin Verior... Ndaj e vitit 1054 i shkakton plagë historisë edhe në fund të shekullit XX". Dhe Ponting konkludon "antisemitizmin e ka lindur krishtërimi, sidomos krishtërimi katolik".

Pra askush nuk mund të mohojë se fashizmi lindi dhe madje u shndërrua në sistem politik shtetëror në vende të krishtera europiane, në radhë të parë katolike.

Edhe komunizmi u lind dhe u rrit në "shtratin e krishterë" europian

Produkti i botës dhe "qytetërimit të krishterë" është dhe totalitarizmi tjetër, komunizmi.

Idetë fillestare të komunizmit gjenden qysh në veprat e filozofëve grekë të lashtësisë. Doktrinën e tyre të "komunizmit shkencor" në shekullin XIX Marks si dhe Engelsi, sipas Leninit, e ndërtuan duke u mbështetur në "gjithçka të mirë që kishte përpunuar njerëzimi", duke filluar qysh me studimin e Epikurit e të tjerëve filozofë të vjetër, me sistemin republikan të Romës e deri te paraardhësit e tyre të afërt, mendimtarët që përgatitën revolucionin francez të vitit 1789, përvojën jakobine, socializmin utopik, revolucionarët e shekullit XIX, përfshi Komunën e Parisit.

Komunizmi që predikonte Enver Hoxha në Shqipëri në kulmin e luftës ideologjike kundër revizionizmit modern sovjetik, në kohën e revolucionit kulturor kinez në vitet 1960 e madje pasi edhe Kina u quajt revizioniste pas vitit 1978, është i njohur shumë më herët dhe pikërisht në Francë. Ky “komunizëm francez” quhet babëvizëm, sipas emrit të drejtuesit të kësaj rryme, Babëfit. Një bashkëpunëtor i Babëfit, Buonarroti ka lënë dy libra për historinë dhe tiparet e babëvizmit. Në vitet 1960-1970 në Shqipëri vinin marksistë -leninistë nga Franca që bënin pjesë në “Celulën Babëf”, pra gëzoheshin që gjenin një model të babëvizmit këtu tek ne.

Komunizmi si ideologji moderne u shfaq, u përpunua dhe u masivizua fillimisht në Europën e krishterë e kryesisht në Gjermani, Francë, Angli, Itali. Këtu filloi të bredhë për herë të parë “Fantazma e komunizmit”, sikurse e thotë fjalia e parë e “Manifestit komunist” të vitit 1848. Pastaj kjo “fantazëm” kaloi drejt Lindjes në pjesën sllavo-ortodokse të botës së krishterë. Pikërisht në Rusi “Fantazma e komunizmit” u kthye në një përbindësh politiko-shoqëror e shtetëror. Ajo u hodh edhe më tej në Lindje dhe pushtoi Kinën taoisto-budiste e pjesë të tjera. Në Ballkan u shtri përsëri nëpërmjet damarëve sllavo-ortodoksë (serbëve, bullgarëve, grekëve).

Në botën islamike “fantazma e komunizmit” nuk gjeti shtratin që i pëlqente. Duhet të kenë ndikuar shumë faktorë që e mbajtën larg. Është e besueshme se faktori kryesor është Islami, që funksionon jo vetëm si besim fetar, por si një sistem i plotë politiko-shoqëror e qytetërues, mjaft liberal dhe sa duhet i konsoliduar dhe i organizuar për të mos lënë shumë hapësira bosh për fantazmën e vjetër dhe hijet e mëvonshme të komunizmit, apo të totalitarizmit fashist.

Është marrëzi me brirë ajo që shkruhet në **“Ora e Shqipërisë”** për një “*inkubator islamiko-bizantin*” nga ku paska dalë një “*feudo komunizëm shqiptar*”. Inkubatori i lindjes së komunizmit është katoliko-perëndimor. Kurse ferma ku u majm dhe u harbua komunizmi është ortodokso-bizantine lindore.

Rrënjët më të thella në Perëndim komunizmi i lëshoi në vendet katolike, Francë, Itali, Gjermani, Spanjë, Portugali. Në vendet protestante nuk pati të njëjtin sukses. Edhe tani pas shembjes së komunizmit në Lindje, Franca e Italia katolike mbeten vendet ku komunizmi qëndron kryeneç dhe ku veprojnë partitë komuniste më të fuqishme dhe më dogmatike. Kurse në Gjermani, atdheun e lindjes, komunizmit i vuri frerin nazizmi e më pas demokracia liberale anglo-amerikane.

Shqipërinë e pushtoi dhe po e nëpërkëmb “komunizmi sllavo-ortodoks”

Në Europën Lindore bastione të komunizmit u bënë vendet sllavo-ortodokse Rusia, Serbia, Greqia, Rumania. Hallka më të dobëta ishin vëndet lindore katolike Polonia, Çekia, Hungaria. Stalini në 1944 i ka thënë Çerçillit “komunizmi i përshtatet Polonisë sa parmenda lopës” (“Le Monde Diplomatique” prill 1990 fq.17).

Qendra botërore e komunizmit pas vitit 1917 u bë Rusia dhe varianti mbizotërues u bë sllavo-komunizmi deri në fillim të viteve 1990. Ky sllavo-komunizëm u bë edhe inkubatori më i madh për komunizmin që u shtri në drejtim të Ballkanit. Sllavo-komunizmi pas krijimit të BS dhe të kampit socialist vendosi paternalizmin e tij mbi gjithë lëvizjen komuniste botërore duke përfshirë shumë kohë edhe komunizmin euro-perëndimor.

Në Shqipëri sllavo-komunizmi i hodhi kthetrat qysh herët, por vendosi sundimin e plotë në vitet e LDB nëpërmjet Partisë Komuniste të Jugosllavisë dhe pas vitit 1948 nëpërmjet sundimit sovjetik.

Fanatikët katolikë si puna e Mark Bregut dhe gazetarëve të **“Ora e Shqipërisë”** le të marrin e të studiojnë me vemendje një shkrim shumë të goditur të zotëri Pjetër Dukës, botuar në datën 14 qershor 2001 në gazetën “55” nën titullin shumë domethënës “Ç’të lidh ty me komunizmin Mirdita ime?”

Kur lexon librin e Pal Doçit “Mirdita vatër e qëndresës antiosmane” (Tiranë 1999) mëson se edhe pse Shqipëria u përfshi 500 vjet në Perëndorinë Osmane, Mirditës i mbeti titulli i nderit

“vatër e qëndresës antiosmane”, nuk iu vu asnjëherë nofka “Turqi e vogël”, sikurse i qenka ngjitur nofka “Moska e vogël”. Është një pasojë rrënimtare e sllavo-komunizmit ortodoks dhe jo e “komunizmit islamik” shqiptar që ende sot një mirditor detyrohet me dhimbje dëshpëruese të shtrojë pyetjen “Ç’të lidh ty Miridita ime me komunizmin”, pse ajo të quhet “Moska e Vogël”?”

Është zotëri Pjetër Duka, një mirditor katolik e jo një matjan mysliman, që ka shkruar kaq saktë të vërtetën se : “ Komunizmi për Mirditën, ashtu si përgjithësisht në veri të Shqipërisë, qe një pushtim i dhunshëm sllav me mercenarizëm shqiptar, pa mbështetje të vullnetshme të popullsisë vendase...Shkjau, që me shekuj s’ia gjeti dot anën shkatërrimit të Shqipërisë, më në fund, ia doli për mrekulli përmes penetrimit të kalit komunist të Trojës nga brenda. Fara e keqe e hithrës lëshoi rrënjë edhe në Saharanë e Mirditës”.

Kjo farë e keqe e hithrës është pikërisht sllavo-komunizmi ortodoks dhe jo ndonjë “komunizëm islamik” që shpikin fanatikët katoliko-centristë dhe euro-centristë të Partisë Demokristiane (termat e fundit i kam huazuar nga libri i studiuesit nga Kosova Nexhat Ibrahimit me titull “ Islami në trojet iliro-shqiptare gjatë shekujve”, Logos-A, Shkup,, 1998).

“Inkubatori islamiko-bizantin” i komunizmit shqiptar, shpikje euro-katolikocentriste

Pas asaj që u parashtrua më lart natyrshëm lind pyetja : si paska ndodhur që vetëm në Shqipëri, sipas “Orës së Shqipërisë”, qenka ngritur një “inkubator islamiko-bizantin” i komunizmit për të çelur zogj komunistë që nuk gjenden në pjesë të tjera të botës?!

Kjo nuk duhet marrë vetëm si një “shpikje-shpifje” njerëzish që nuk kanë haber për të tilla probleme si puna e Mark Bregut. As nuk mund të besohet se Zef Bushati me demokristianët e tij “kanë kapaçkë”, siç thonë korçarët, të përpunojnë të tilla teza spekuluese e provokuese, të sajojnë “feudo-komunizma shqiptarë” të çelur në “inkubatorë islamiko-bizantinë”.

Sajesa të tilla janë bërë së pari nga ata që kanë formuluar edhe tezat për Shqipërinë si “depo e municionit islamik”, tezë të cilën e solli me alarm nga Franca dhe e shpalli me kërcënim Neshat Tozaj nëpërmjet “ZP” të datës 10 janar 1995,. Ja ku është precedenti i asaj që bën tani **“Ora e Shqipërisë”** me nënshkrimin e Mark Bregut. Para Tozajt ka qënë Kadareja që ka shpallur në Francë se myslimanizmi dhe komunizmi ishin armiq të mëdhenj të shqiptarëve që ndanë Shqipërinë e shqiptarët nga Perëndimi. Para Mark Bregut ka qënë edhe ambasadori i Berishës në Francë, Besnik Mustafaj, që duke thyer edhe disiplinën shtetërore dënoi publikisht hyrjen e Shqipërisë në Konferencën e vendeve islamike.

Por më të qartë se kudo autorësinë franko- katolike të “shpikje- shpifjes” së **“Orës së Shqipërisë”** për prejardhjen islamike të komunizmit në Shqipëri e gjejmë në një libër francez me titull “Shqipëria ose logjika e dëshpërimit”, botuar në Francë në vitin 1992 dhe në shqip në Tiranë në vitin 1998. Autorë të librit janë çifti i “mësimdhënësve” francezë Zhan-Pol dhe Elizabet Shanse, që pas disa vite shërbimi në Shqipëri kanë shkruar me një keqdashje të veçantë për Shqipërinë dhe shqiptarët.

Në faqen 73 të librit shkruhet: “Shqipëria si tokë e paradokseve e futi komunizmin nëpërmjet myslimanëve, pastaj komunizmi u imponua dhe po nëpërmjet myslimanëve, Shqipëria po “europianizohet”. Figurat e mëdha të komunizmit si Ali Kelmendi, Enver Hoxha, Mehmet Shehu, Myslym Peza, Qemal Stafa janë myslimanë”. Në faqen 74 të këtij libri çifti ngacaman francez për çështjen e përhapjes së komunizmit në Shqipëri shkruan: “Në mendjen e shumë të krishterëve komunizmi i pafe ngatërrohet me Islamin pushtues”. Në këtë fjali kemi provën e plotë përse Mark Bregu dhe katolikë të tjerë fanatikë të PDK-së e të **“Orës së Shqipërisë”** vulgarizojnë e egërsojnë provokimet dhe trillimet e librit të Shanse-ve për “komunizmin islamik” në Shqipëri.

Në ngjashmëritë midis citimeve nga shkrimi i **“Orës së Shqipërisë”** të datës 6 prill 2001 dhe të librit të francezëve kemi provën e pakundërshtueshme se nga u vijnë frymëzimet (

mbase edhe instruksionet) Mark Bregut e të tjerëve për të fallsifikuar historinë e shqiptarëve, për të sulmuar Islamin dhe myslimanët shqiptarë.

Në librin e francezëve është dhe një fjali tjetër që synon të nxisë sherre e konflikte fetare midis shqiptarëve. “Për më tepër duket se bektashinjtë duhet të kenë qenë më tepër frank-masonë. Kundër tyre është ngritur ndonjëherë akuza për ateizëm” (fq. 65). Si për “çudi” kur në një shkrim të paradokohëshëm kam përmendur “masonërinë gjirokastrite”, gazetari Mero Baze është kundërpërgjigjur se po diskriminoja bektashinjtë e Jugut.

Është edhe një fakt tjetër flagrant që provon se direktivat për të nxitur grindje fetare në Shqipëri dhe për ta quajtur islamik “komunizmin shqiptar”, vijnë nga Perëndimi katolik. Më 4 Maj 1997, pra në kohën kur Shqipëria ishte ende në pikën e nxehtë të luftës civile që kishin nisur greko-sllavo komunistët e mercenarët e tyre shqiptarë në Jug, në gazetën “Bota Sot” është ribotuar një intervistë që Ismail Kadare ia kishte dhënë gazetës kroate “Globus”. Kadare ishte munduar t’i shpjegonte gazetarit kroat se ajo përplasje me armë që po ndodhte në Shqipëri ishte rrjedhojë e një ndarjeje armiqësore midis komunistëve dhe nacionalistëve shqiptarë qysh në vitet e LDB. Kadareja i thoshte kroatit se kjo ndarje u përsërit në vitin 1997.

Mirëpo kroati kishte në mendje të provonte një “shkak” tjetër të përleshjeve me armë në Shqipëri dhe pa kurrfarë lidhje logjike me shpjegimet e Kadaresë i drejton këtij pyetjes provokuese për shqiptarët: “A thua ndarja për të cilën po flisni është e lidhur me religjionet e ndryshme në Shqipëri? Sipas disa interpretimeve si duket fjala është për konflikt midis myslimanëve dhe katolikëve”.

Kadare nuk ka rënë në grackën e kroatit dhe është përgjigjur: “Jo, kjo ndarje absolutisht nuk qëndron. Këto janë fjalë naive që nuk rrjedhin nga shqiptarët”. Mirëpo tani që kemi shkrimin e Mark Bregut në **“Ora e Shqipërisë”** edhe Kadare duhet të bindet se këto fjalë nuk kanë qenë aspak naive dhe se ato rrjedhin papagallçe edhe nga gojë shqiptare. Edhe të huajt ato fjalë nuk i kanë lëshuar asnjëherë nga naiviteti. Nuk janë fjalë naive ato që shkruan çifti francez në librin “Shqipëria dhe logjika e dëshpërimit”. Nuk kanë qenë nga naiviteti afishet që ka parë Neshat Tozaj në Paris në vitin 1995 “Shqipëria depo municioni islamik”. Nuk kanë qenë aspak fjalë naive ato të gazetarit kroat, i cili ka bërë dhe gafën, duke e quajtur konfliktin e filluar në Vlorë, Sarandë dhe Gjirokastrë si konflikt midis myslimanëve dhe katolikëve. Kroati madje nëpërmjet pyetjes së tij ka zbuluar se shprehte jo një mendim personal, por një opinion më të gjerë të interesuar për të nxitur sherr midis katolikëve dhe myslimanëve në Shqipëri.

Ato që shkruan Mark Bregu tani në **“Ora e Shqipërisë”** janë në vazhden e dëshirave që ka shpalosur gazetari kroat gjatë intervistës me Ismail Kadarenë në vitin 1997.

Një lexues katolik i “Rimëkëmbjes” na ka shkruar se Partinë Demokristiane të Zef Bushatit duhet ta vlerësojmë më shumë si një ambasadore të Shqipërisë në rradhët e forumit të Partive Popullore të Europës. Por me këto që shkruhen në **“Ora e Shqipërisë”** kundër nacionalizmit e myslimanizmit në Shqipëri jemi të detyruar ta shohim më shumë si përçuese të provokimeve politiko-fetare përçarëse që përpiqen të bëjnë mjedise të caktuara sherrxhije të Europës në Shqipëri.

Për fat të keq edhe një atdhetar i nderuar si Prenk Gruda në parathënien e librit të Nikoll Mazrekut kundër Kordinjanos, pa qenë nevoja komunizmin shqiptar e ka lidhur me bijtë e hoxhallarëve e të shehlerëve, gjë që në një farë mënyre përforcon përshtypjen se tek shqiptarët e besimit katolik është mjaft e përhapur psikoza e keqe për ta lidhur komunizmin me myslimanizmin. Çifti francez e ka patur një shtytje nga konstatimet e bëra kur e ka vënë në libër këtë mendim.

Trillimi për “komunizmin islamik” ushqen strategjinë e zhbërjes së Shqipërisë

Pranvera e vitit 1997 na dha male me dëshmi se është ndërtuar një strategji shkatërruese ballkanike dhe europiane kundër kombit shqiptar.

Për këtë punohet në shumë drejtime : shtetërore, organizata e shoqata jo qeveritare, shërbime agjenturore e deri organizma fetare të Ballkanit dhe të Europës. Propaganda perëndimore në vitin 1997 u vu haptazi e me zell të turpshëm në shërbim të kësaj strategjie dhe vazhdon ta bëjë këtë punë në mënyrë pak më të maskuar. Ngjarjet e tanishme në Shqipërinë Lindore, ku e tërë diplomacia europiane, duke përfshirë edhe hierarkët më të lartë të NATO-s ka marrë anën e terrorizmit e genocidit maqedon mbi shqiptarët është një provë e re e strategjisë që u përmend. Dhe pikërisht në këtë kohë **“Ora e Shqipërisë”** del para shqiptarëve me tezën absurde dhe provokuese se shqiptarëve asnjëherë nuk u paska ardhur ndonjë e keqe nga komunizmi sllavo-ortodoks, por rreziku u ka ardhur dhe u ardhka nga myslimanizimi që u bë edhe shtrati i feudo-komunizmit shqiptar.

Pra, **“Ora e Shqipërisë”** i shkon sipas idesë Koshtunicës që trumbeton teorinë se konflikti në Ballkan pas rënies së Millosheviçit do të jetë vetëm një konflikt i brendshëm i shqiptarëve. Prandaj duan të ngrenë të krishterët shqiptarë kundër myslimanëve shqiptarë nën flamurin e dalë boje të revanshit katolik kundër myslimanizimit të shqiptarëve.

Ja se në mullirin e kujt çojnë ujë **“Ora e Shqipërisë”** dhe kalemxhinjtë e saj kur trumbetojnë se rreziku kryesor për shqiptarët qenka komunizmi islamik e jo sllavo-komunizmi, se islamizmi për shqiptarët qenka edhe më i keq se komunizmi.

Kjo strategji politike serbe që e shpall tani vetë Koshtunica është e herëshme. Ja si na e ka shpjeguar studjuesi kanadez i historisë së Shqipërisë, Robert C. Austin: “Që nga krijimi i Shqipërisë së pavarur politika e Beogradit përcaktohej nga mendimi se Shqipëria është komb i ndarë, i destinuar për luftë për pushtet ndërmjet pakicës së krishterë dhe shumicës së myslimanëve dhe se këto kontradita brenda saj do të ishin shkak i paqëndrueshmërisë së pashmangshme. (“Shtegu i pashkelur i Fan Nolit. Albin 2000, anglisht 1998).

Robert Austin e ka shpjeguar edhe këtë që bëjnë fanatikët katolikë dhe PDK, sot kur ka shkruar: “Pakica katolike edhe pse në thelb me pikëpamje përparimtare në krahasim me bejlerët ishte para se gjithash për një program krahinor klerikal. Njësoj si toskët ortodoksë edhe ata kishin pikëpamjen dhe e vinin vehten në krye përse i përket kulturës dhe artit” (fq.37). “Ora e Maleve”, një grup klerikësh katolikë përfshinte dhe patriotët e dëgjuar Luigj e Shuk Gurakuqi, bastioni i veprimtarisë antizogiste ishte i shqetësuar nga mbizotërimi në Tiranë i çifligarëve myslimanë. (fq.36)”.

Për ëndrrën, projektet e përpjekjet e një “republike katolike” në Mirditë lexuesi i interesuar mund të informohet gjërësisht në librin e historianit Pal Doçi “Mirdita, vatër e qëndresës antiosmane”.

Pra dikur “Ora e Maleve” e bënte politikën e fanatizmit klerikalist katolik në emër të luftës kundër bejlerëve myslimanë. Kurse tani **“Ora e Shqipërisë”** të njëjtën gjë përpiket ta bëjë në emër të luftës kundër “feudo-komunizmit mysliman shqiptar”. Kështu asgjë nuk ka ndryshuar nga ajo që përshkruan Robert C. Austin.

“Feudo-komunizmi islamik” shqiptar një marrëzi teorike

Vetëm më kryeneçët e fanatizmit katolik mund t'i hyjnë këmbë detit të trillimit për të shpallur se paska në botë një “feudo-komunizëm islamik” shqiptar dhe për të akuzuar Islamin si burim i komunizmit .

Lenini në shkrimin e tij të famshëm mbi prejardhjen dhe strukturën e marksizmit “Tre burimet dhe tri pjesët përbërëse të marksizmit” jo vetëm Islamin, por asnjërin nga tri fetë monoteiste nuk i përmend si burim, apo si mbështetëse të marksizmit. Lenini mbante parasysh mendimin e Marksit se “Traditat e gjithë brezave të vdekur si male rëndojnë mbi mendjet e të gjallëve”. Në mendjet e themeluesve dhe udhëheqësve të komunizmit rënduan traditat e brezave të krishterimit, jo të myslimanizmit. Lenini nuk mund ta bënte këtë sepse komunizmi ishte antipodi i fesë, ishte ateizmi vetë, ndonëse siç e ka përcaktuar më saktë

politikani e shkrimtari komunist sllavo-malazez Milovan Gjilas “ateizmi është fe e kthyer kokëposhtë”.

Para se ta lexoj këtë mendim në një revistë sovjetike kam patur rast ta dëgjoj nga një ambasador i një vendi të Karaibeve në OKB, i cili gjatë një dreke më pyeti se çfarë feje zyrtare kishte në Shqipëri. Kur i dhashë përgjigjen se nuk kishte fe zyrtare, dhe në përgjithësi nuk praktikohej feja shtoi: Po çfarë jeni? Pas fjalëve të mia “jemi ateistë” ai shtoi: Ja pra dhe ju keni një fe dhe feja juaj qenka ateizmi, pasi ju besoni në këtë. Antifeja, sipas këtij ambasadori, apo “feja e kthyer kokëposhtë” sipas Gjilasit, që në vendet socialiste u quajt komunizëm, sipas shumë dijetarëve nuk është krijuar dhe zhvilluar në mënyrë krejt të shkëputur nga feja e ritet dhe ka qënë shumë e lidhur me krishterimin, sidomos me ortodoksizmin

Komunizmi ka huazuar shumë nga krishterimi

Një ekonomist i njohur, Keins ka thënë: “Leninizmi bashkon dy gjëra fenë dhe biznesin”.... Si fetë e tjera edhe feja komuniste persekuton pa mëshirë, pa fare drejtësi ata që e kundërshtojnë” (Revista e përjavshme “Kohët e reja” varianti frengjisht, Moskë 34/1990). Në revistën studimore “Obshestvenije nauki” (Shkencat shoqërore), organ i Akademisë së Shkencave të B.S, nr.4, viti 1990, faqe 129 është një fjali e tillë “Çdo ideologji masive, qoftë marksizmi, qoftë krishtërimi ka elemente të mesianizmit”. Diçka të përafërt shpreh edhe autori Genadij Hazanov në artikullin “Përse na dënuan me lumturi të përgjithshme”, kur thekson: “Lenini u zgjodh nga historia që mësimin tragjik ta çonte deri në absurd. Nuk duhet të bëjmë vetëm Stalinin shkaktar të fatkeqësive. Lejen për terror e nënshkroi Lenini” (Revista e ilustruar e përjavshme sovjetike “Ogoniok” nr.35, viti 1990, fq.20). Po në revistën “Ogoniok” nr.24, viti 1990, fq. 9 shkruhet: “Partia Komuniste e BS u kthye në një organizatë pushteti, në një farë shteti - kishë, ku marksizmi i fallsifikuar doli si surrogato i përshtatshëm i fesë. Parrulla e internacionalizmit proletar kamuflloi strukturat imperiale të vendit, kurse dordoleci i pronësisë private si bazë shfrytëzimi shenjtëroi sistemin burokratik të drejtimit. Por e vërteta e partisë qe pushteti”.

Solla vetëm disa citate nga literatura sovjetike që, pas perestrojkës, ka qënë më e prirur për të trajtuar këto probleme.

Për të plotësuar argumentin se komunizmi është i lindur në shtrat të krishterë dhe është bastarduar në shtrat të krishterë ortodoks kur mori fizionominë e sllavo-komunizmit po i referohem dhe filozofit të njohur britanik Bertran Rasell që ka thënë: “Bolshevizmi nuk është vetëm një doktrinë politike, por edhe një fe me dogmë e shkrime të shenjta”. (“Kohët e reja”, Moskë, varianti frengjisht nr.17 viti 1990 fq.41).

Komunistët janë “katolikë të kthyer mbrapsht”

Me keqardhje detyrohem ta shkruaj edhe këtë, por fanatikët katolikë ta bëjnë borxh të përdorësh drejtpërdrejt edhe argumentin më goditës.

Për fat të mirë shpjegimin që kanë kërkuar nëpërmjet Mark Bregut dhe që meritojnë t’ua thuash, fanatikët katolikë e kanë marrë nga të tjerë para nesh që detyrohemi të polemizojmë me ta. Madje e kanë marrë nga burra të shquar e të ditur, nga politikanë të besimit katolik, të tillë si Alen Peirefit, disa herë anëtar qeverie në Francë dhe ish-sekretar i përgjithëshëm i partisë golliste, për të cilin intelektual shqiptaro-amerikan, Miftar Spahija i shkruante më 29 tetor 1978 kryetarit të bashkisë së Parisit, tani president i Francës, Zhak Shirakut, : “Do të kisha dashtë që z.Peyrefitte të shkruante një “Sëmundja shqiptare’ siç ka shkruar “Sëmundja franceze” (Shih “Rreth Kosovës” shtëpia botuese “Koha”, Tiranë 1999, fq.23)

Në veprën e tij “Le Mal français” (Sëmundja franceze) volumi i dytë, fq. 668-669 nën titullin “Partia e re romake”, Peirefit ka shtruar pyetjet : “ Pse partia komuniste është e fuqishme në Francë, Itali, Portugali dhe thuajse në të gjitha vendet (amerikano)latine, të cilat i shpëtuan pushtetit të saj vetëm duke rënë nën një diktaturë ushtarake? Përse ajo arriti t’ua prishë

mendjen kaq shumë intelektualëve që madje ishin edhe të shkathët në kritikë? Kurse në vendet anglo saksone partitë komuniste, sikurse edhe lëvizjet fashiste, janë katandisur në një rol folklorik?”

Në përgjigje të këtyre pyetjeve retorike ai vetë sqaron : “ Midis gjithë shoqërive industriale aspiratat revolucionare kanë gjetur terrren në ato që kanë pësuar zgjedhën e një hierarkie të rëndë politiko-shpirtërore. Ato mbaruan shpejt në shoqëritë që njohën qysh herët struktura të decentralizuara, lirinë e inisiativës dhe një aftësi të madhe për përshtatje ndaj ndryshimit.

Komunizmi është një kundërshoqëri...Modeli romak jeton në komunizmin në formë negative. Ai merr format e jashtëme të një kishë. Ai mbështetet në tekste të shenja, ai është i dhënë pas interpretimit të tyre korrekt, ai kultivon vlerat e disiplinës kolektive dhe të nënshtrimit. Për besnikët e vet ofron rite të jashtëme, dogmë kompakte e siguri të brendshme. Ai di të ndëshkojë, por edhe të ndihmojë e të rrethojë me kujdes. Në Francë e vendet latine fryn gjithmonë fort fryma romake: sindikatat më të forta, partitë të rrënjësura më së miri që u binden të njëjtave parime organizimi si Kisha që ka qenë gjatë kaq shumë shekujsh edukuesja e madhe e shoqërisë. Komunistët janë katolikë të ktheyr mbrapsht (si xhakët), por katolikë të kohës para Vatikanit II”.

Kështu ka shkruar një personalitet francez si Peirefit. Komunizmi në Shqipëri e kudo ngjashmërinë më të madhe e ka me fenë e krishterë e kishën katolike. “Inkubatorët komunistë islamiko-bizantinë” në Shqipëri nuk kanë ekzistuar ndonjëherë. Ata që mund të ndërtojë Mark Bregu nuk mund të çelin zogj si dëshiron ai, “komunistë-islamike”, sepse komunistët qenkan “katolikë të kthyer mbrapsht”.

Pas këtyre fjalëve fanatikëve tanë katolikë u duhet kujtuar se “pushkatimi politik”, sikurse quhej përjashtimi nga partia, është praktika e shkishërimit nga katolicizmi dhe ortodoksia e nuk njihet në fenë islame. Praktika e rrëfimit tek prifti i shërbeu komunizmit për të vendosur normën që anëtar i partisë duhej të “xhvishej” në mbledhjet e organizatës së partisë ose para forumeve dhe të rrëfente çdo mëkat; vetëqortimi, autokritika e jetës partiake komuniste është praktika e flagjelacionit (vetëkamxhikimit) fetar katolik. Më këtë praktikë fetare përherë të parë jam njohur kur isha diplomat i ri dhe ambasadori polak na kishte ftuar në shfaqjen e filmit “Nëna Joanë”, kur kishte skena të vetkamxhikimit për larje mëkatesh. (Pra edhe në kohën e komunizmit bëhej propagandë fetare). Shëmbëlltyra e hierarkisë kishtare u përdor në hierarkinë e rreptë komuniste sipas parimit të “centralizmit demokratik”. Po kështu praktikat e shenjtoreve, ikonografisë. Komunizmi rus huazoi shumë sidomos nga ortodoksia dhe bizantinizmi. Stalini pat mësuar për prift dhe jo për hoxhë. Enverizmi është stalinizëm, jo hoxhallëk, as kemalizëm. Në “komunizmin shqiptar” Enver Hoxha imitoi mbase nga myslimanizmi format e edukimit politik në ditët e premtë. Por gjithçka tjetër e huazoi nga komunizmi francez, sllav, kinez.

Fallsifikimet demokristiane për përhapjen e komunizmit në Shqipëri

Në Shqipëri komunizmi nuk erdhi nga bota islamike por nga bota e krishterë katolike dhe ortodokse, nga Franca, Italia, Serbia, Greqia, Rusia bolshevike.

Idetë e literatura komuniste në Shqipëri nuk hynë nëpërmjet kontakteve me botën islame, nëpërmjet literaturës në arabisht, persisht, turqisht, por nëpërmjet literaturës në frengjisht, italisht, greqisht e më pas në rusisht.

Petro Marko, komunist i bindur, në një libër kujtimesh të sinqerta ka dëshmuar se ai dhe bashkënxënësit e shkollës tregtare të Vlorës, që u bë çerdhe e fidanishte e begatë komuniste, për herë të parë “Manifestin komunist” e morën nga një mësimdhënësit italian në atë shkollë. Ai tregon gjithashtu se si literatura marksiste hynte nga Greqia në Shqipëri. Dokumentat janë të shumta se si botimet marksiste vinin nga Franca, ku botoheshin dhe gazeta komuniste shqiptare. Edhe protagonistët e hedhjes, mbjelljes, prashitjes, vaditjes e korrijës së ideve e praktikave komuniste në Shqipëri kanë qenë në radhë të parë të krishterë, sidomos ortodoksë, midis të cilëve kishte shumë me origjinë sllave, vllahë ose me lidhje të forta greke.

Me spekulime si ato që bëjnë çifti francez Shanse apo shkruesit e **“Orës së Shqipërisë”** këto fakte nuk fshihen dot, sepse nuk mbulohet dielli me shoshë. Vetëm fakti që në krye të PPSH doli Enver Hoxha në vitet e LDB dhe Enveri e Mehmet Shehu ishin në krye të pushtetit komunist në Shqipëri nuk mund të provojnë se ata krijuan një “feudo-komunizëm islamik shqiptar”. Ata ishin më ateistët nga komunistët shqiptarë dhe Islamin në Shqipëri e dëmtuan edhe më shumë se fetë e tjera përse i përket perspektivës së ripërtëritjes. Nga udhëheqësit e lartë komunistë të Shqipërisë më i vendosuri për të mbrojtur repartet e fesë që i përkiste njihet Tuk Jakova dhe jo Hoxha e Shehu.

Është interesante të krahasoh shkrimet e çiftit francez Shanse dhe të Mark Bregut që synojnë të vërtetojnë se komunizmi në Shqipëri ishte vepër e myslimanëve. Francezët përmendin kryesisht drejtues komunistë nga koha e LDB si Enver Hoxha, Mehmet Shehu, Qemal Stafa, Myslim Peza (që deri vonë nuk ishte fare komunist). Mark Bregu në vend të Myslim Pezës vendos Manush Myftiun, kurse Hysni Kapon që ishte më i rëndësishëm se Manushi nuk e përmend. Si duket për Markun ka më tepër rëndësi që të theksojë tre mbiemra që janë ofiqe fetare: hoxhë, sheh, myfti. Marku nuk ze në gojë Qemal Stafën, siç bëjnë francezët, sepse pastaj nuk përlligj dot që kryetari i grupit komunist të Shkodrës Zef Malaj ku bënte pjesë Qemali, nuk paska qenë komunist por social-demokrat.

Ndryshe nga francezët Marku rrënjët islamike të komunizmit shqiptar i kërkon më herët, para LDB dhe përmend Halim Xhelon, Riza Cerovën e Ali Kelmendin. Është e saktë që Halim Xhelo nga Vlora ka qënë një ndër të parët protagonistë të përhapjes së komunizmit në Shqipëri, por i eurokomunizmit. Kurse Riza Cerova dhe Ali Kelmendi nuk kanë qenë protagonistë të përhapjes e të vendosjes së komunizmit në Shqipëri. Ata ishin ushtarakë të rangjeve të ulta në vitet e para të shtetit shqiptar, që pastaj pas “revolucionit bolshevik shqiptar të qershorit” në qershor 1924 përfunduan në BS ku u bënë agjentë të rëndomtë të KGB-së dhe u përdorën për misione korrieri e informatori, ose agjenti për krijim turbullirash.

Me të tillë misione u dërguan në Shqipëri në mesin e viteve 1930. Cerova u vra pas shtypjes së kryengritjes së Fierit në vitin 1935 ku ai merrte pjesë si agjent i KGB-së. Kurse Ali Kelmendi ka kryer vetëm një mision: solli në Shqipëri si korrier direktivat e Kominternit dhe ka dërguar raporte. Nuk ka mbajtur asnjë funksion drejtues e organizues. Nuk ka bërë asnjë veprimtari në Veri të Shqipërisë, siç shkruan **“Ora e Shqipërisë”**, sepse u detyrua nga qeveria të banonte në Korçë e Gjirokastër para se të largohej për në Paris ku vdiq. Rolin e Ali Kelmendit e ka fryrë Enver Hoxha që të ulte rolin e drejtuesve e të krerëve të tjerë komunistë të grupeve të Shkodrës, Korçës, Të të Rinjve, të Zjarrit para themelimit të PKSH. **“Ora e Shqipërisë”** u përmbahet këtyre spekulimeve të Enverit dhe të historiografisë enveriste.

Çifti francez Shanse u bën bisht fakteve që provojnë se më shumë komunizmi Shqipërisë i erdhi nga Franca, meqenëse edhe “myslimani” Enver Hoxha ishte produkt i shkollës franceze dhe i stërvitjeve në Francë edhe për komunizëm, se Mehmet Shehu komunizmin e mësoi në Spanjë etj.

Komunizmi në Shqipëri fillesat e tij i ka pasur nëpërmjet veprimtarisë së njerëzve me të cilët bashkëpunoi ngushtë grupi klerikalisto-politik **“Ora e Maleve”**. Të interesuarit le të lexojnë librin e Robert Austin që rreshton fakte interesante për fillimet e komunizmit në Shqipëri, të cilat historiografia jonë i ka anashkaluar, ose ngjyrosur ndryshe nga realiteti.

Fillesë e komunizmit në Shqipëri ishte propozimi për të mbajtur heshtje në parlamentin shqiptar për vdekjen e Leninit në fillim të vitit 1924. Propozimi ishte i Avni Rustemit, kryetar i shoqërisë “Bashkimi” me orientim komunist e terrorist që në programin e saj kishte luftën e klasave dhe ndërtimin e shoqërisë pa klasa. Në kohën kur bëheshin të tilla diskutime në parlament në lozhë gjendej një gazetar sovjetik që si përkthyes shoqërues kishte Kostandin Boshnjakun, njeriun që nga të parët solli mësimet, jehonën e ndikimin e Revolucionit të Tetorit dhe të bolshevizmit në Shqipëri qysh në fillim të viteve 1920. (shih fq.251 të librit të Austin). Boshnjaku kishte qenë në Rusi në kohën e Revolucionit të Tetorit.

Fitorja e revolucionit të Nolit e Gurakuqit ishte një imitim i revolucionit bolshevik dhe marshimit fashist mbi Romë. Sipas Austin “së fundi fitorja e Nolit ishte gjithashtu rezultat i

pakënaqësisë së kombinuar të popullsisë katolike e ortodokse” (fq.106). Austin nuk argumenton nëse kjo pakënaqësi kishte bazë, apo ishte e stisur dhe e nxitur. Por Austin vëren se “shumë nga përkrahësit e Nolit prireshin për të qenë prosovjetikë si ai” (fq. 196), sidomos ministri i tij i Arsimit Stavro Vinjau. Bashkëpunëtor i ngushtë i Nolit ishte edhe Luigj Gurakuqi, madje Noli është qortuar se ishte bërë vegël e Gurakuqit. Ishte një hapje dyersh për depërtimin e ndikimit bolshevik ajo që bëri qeveria e Nolit dhe e Gurakuqit kur në kundërshtim me politikën dhe kërkesat e Europës vendosi marrëdhëniet diplomatike me BS për ta bërë Shqipërinë qendër të bolshevizmit në Europë. Një njeri i Gurakuqit, Nushi, i emëruar për nepotizëm konsull në Vienë u dha vizat me nxitim diplomatëve sovjetikë që të mbërrinin sa më parë në Tiranë. (fq. 276).

Austin përmend se në zgjedhjet e vitit 1923 për Asamblenë Kushtetuese, nolistët më shumë sukses patën në prefekturën e Shkodrës dhe në zonat me popullsi ortodokse në Jug. Kurse Zogu pati më shumë sukses në prefekturën e Dibrës, Elbasanit, Tiranës, Durrësit dhe popullsinë myslimane në Jug. Austin citon gazetën “Shqiptari i Amerikës” që botohej në Korçë të datës 8.12.1923 që shkruante se “në zonat katolike vetëm 200 vota i shkuan qeverisë” (fq. 281).

Tek Austin lexojmë se “pakica katolike për një kohë të gjatë e kishte konsideruar qeverinë e Zogut si armike të katolicizmit”. Edhe Fishta njihet për antizogizmin e tij që e ka shfaqur edhe në fjalën revolucionare që mbajti në varrimin e Avni Rustemit në Vlorë.

Për përhapjen e komunizmit në Shqipëri kanë punuar elementë që u lidhën me këtë ideologji, ose më organizimin komunist qysh herët nëpër vende të tjera, si psh: Anastas Plasari që ishte bërë komunist qysh në vitin 1925 në Rumani. Në Korçë njëra nga qendrat kryesore të lëvizjes komuniste, ata që krijuan organizatat komuniste ishin pothuaj të gjithë ortodoksë. Tashmë është bërë e njohur thënia e Koço Tashkos se në mbledhjen e grupeve komuniste për themelimin e partisë më 8 nëntor 1941 në Tiranë, ai e mori nga rruga Enverin, sepse duhej një mysliman midis ortodoksëve që përfaqësonin Grupin e Korçës. Të përmendur për përhapjen e komunizmit në Korçë ishin Koçi Xoxe, Koço Tashko, Miha Lako, Sotir Gurra, Sotir Vullkani, Stefo Grabocka, Pilo Peristeri e të tjerë. Por edhe më të hershëm e më të dëgjuar ishin Zai Fundo, zjarristët e Aristidh Qendros.

Bashkëshortja e Koçi Xoxes në një rrëfim para Gjergj Titanit (botuar në “Intervista” të datës 30 Prill 2001) dëshmon se Koçi Xoxe, i lindur e rritur në Greqi, erdhi në Shqipëri nga viti 1930 dhe u vu në krye të Grupit komunist të Korçës derisa nga Moska u kthye Koço Tashko për të marrë këtë detyrë.

Punës për përhapjen e komunizmit në Shqipëri i dha hov krijimi i KONARE-së në mërgim nga përkrahësit e Fan Nolit e të Luigj Gurakuqit që u arratisën nga Shqipëria në dhjetor të viti 1924.

Në Veri komunizmin nuk e ka përhapur një korrier i KGB-së, si Ali Kelmendi, por Grupi Komunist i Shkodrës, që kryesohej nga një katolik, Zef Malaj dhe ku siç shkruan vetë **“Ora e Shqipërisë”** bënë pjesë disa persona të tjerë me emra e mbiemra katolikë.

Partinë Komuniste të Shqipërisë e themeluan të dërguarit sllavo-komunistë, serbo-malazes Miladin Popoviç e Dushan Mugosha. Në librin e Enver Hoxhës “Kur lindi Partia” kjo del qartë, ndonëse Enveri është munduar gjithmonë të hiqet si themeluesi i PKSH. Kurse Mark Bregu dhe **“Ora e Shqipërisë”** rolin e Popoviçit e të Mugoshës e kalojnë krejtësisht në heshtje se duan ta paraqesin komunizmin në Shqipëri vetëm si vepër të Hoxhës, Shehu e Myftiut.

Bregu dhe **“Ora e Shqipërisë”** hiqen sikur nuk e dinë se pas themelimit të PKSH në Veri të Shqipërisë protagonistët më të rëndësishëm të komunizmit u bënë persona me emra e mbiemra katolikë si Tuk Jakova e Gjin Marku. Ato bëjnë sikur nuk dinë se në Shkodër e në Tiranë me rëndësi të madhe kanë qenë sllavët Vasil Shanto, Kristo Themelko, Branko Kadia, Vojo Kushi. Në librin “Kur lindi partia” Enver Hoxha shpjegon se në Tiranë qendër për të mbajtur kontakte me komunistët shkodranë ishte shtëpia e Bojka Lazrit. Ja pra sa shumë

emra sllavësh dalin nëpër faqet e librave mbi historitë e përhapjes së komunizmit në Shqipëri, si në Jug dhe në Veri, si midis komunistëve të Korçës dhe atyre të Shkodrës që përbënin kontigjentin bazë të PKSH-së më pas!

E megjithatë **“Ora e Shqipërisë”** orvatet në vitin 2001 që këto zhvillime t’i emërtojë “feudo-komunizëm islamik shqiptar” dhe jo “sllavo-komunizëm në Shqipëri”, sikurse ishin.

“Ora e Shqipërisë” bën “rinovim të vonuar” të komunistëve të parë

Bregu dhe **“Ora e Shqipërisë”** kujtojnë se i përjashtojnë katolikët nga veprimtaria komuniste në Shqipëri duke i shpallur Zef Malajn, Tuk Jakovën, Mark Ndojën e të tjerë në Veri, sikurse Zai Fundon dhe Sejfulla Malshovën në Jug jo komunistë, por social-demokratë liberalë (si Gjinushi e Teodor Laço në vitin 1991).

Kohët e fundit ka dalë edhe një bashkëpunor i hershëm i Mehmet Shehut që pretendon se edhe Mehmeti paska qenë social-demokrat, madje i djathtë fare sepse në kohë e LDB, sapo ishte kthyer nga internimi në Francë me ndihmën e Jakomonit kishte bërë një program politik më të ndryshëm nga ai i Partisë Komuniste. Në fakt ky program përfaqëson një majtizëm ekstrem të spërkatur me pak shurup demokracie (shih shkrimet e Dashnor Kaloçit me kujtime të vjelura nga Idriz Seiti, botuar në “Gazeta Shqiptare” në qershor 2001).

Tani ka një fushatë mjaft të gjerë që tërë përgjegjësinë e fajet për komunizmin e paudhësitë e komunizmit në Shqipëri t’ia lënë vetëm Enver Hoxhës, madje edhe për periudhën deri në vitin 1941 kur ai nuk merrej fare me komunizmin. Gjergj Titani nëpërmjet gazetës “Intervista” merret me rehabilitimin e politikës e praktikave të Koçi Xoxes dhe të xoxistëve të tjerë që bënë kërdrinë në Shqipëri për llogari të jugosllavëve deri sa e pësuan në spastrimet pas prishjes Stalin-Tito.

Social-demokracia ishte vetë komunizmi deri në fillim të viteve 1920 kur u bë diferencim midis komunistëve e socialistëve në Europë. Ata që ishin me ide social-demokrate liberale u ndanë nga krahu i atyre që u quajtën komunistë. Prandaj të gjithë ata që kanë milituar në grupet komuniste në PKSH nuk ishin social-demokratë. Në kohën e LDB në Shqipëri ishin të tjerë ata që krijonin Partinë Social-Demokrate. Fundo ishte komunist si të tjerët, madje më doktrinar se të tjerët. Në një shkrim të Uran Butkës në gazetën “RD” të datës 29 shtator 2000 theksohet : “ Ja si i shkruan Llazar Fundo nga Moska F.S. Nolit : “Komunizma që ne e idealizojmë si Krishtin ia kaloka edhe Satanait për nga ligësia”. Në kujtimet e tij gjatë rrugës për të marrë pjesë në Luftën Civile në Spanjë, Petro Marko përmend se Fundo në Paris edhe pas zhgënjimeve në Moskë vazhonte të punonte me komunistët shqiptarë dhe me komunistë të huaj që kryenin detyra të Kominternit.

Koço Tashko i qëndroi deri në fund besnik variantit sovjetik të komunizmit. Sejfulla Malëshova ishte komunist i tipit siç ishte Buharini në Bashkimin Sovjetik, jo ndonjë social-demokrat Perëndimi. Buharini që ishte komunist i bindur, që ndihmoi Stalinin të mposhtëte një tjetër komunist ekstremist, Trockin, edhe kur e pësoi keq mbeti komunist i përkushtuar dhe nuk kuptonte se si “Koba” (pseudonim i Stalinin) i tij i dashur nuk e mëshironte, se si partia nuk po e falte për besnikërinë ndaj saj. Në qershor 2001 Televizioni BBC ka transmetuar një program ku shfaqet bashkëshortja e Buharinit në moshë të kaluar duke dëshmuar se burri i saj mbeti dëri në fund një komunist i bindur verbërisht. E pra ky ishte bolsheviku më liberal në trajtimin e problemeve ekonomike, të cilin në radhët e komunizmit shqiptar u përpoq ta imitonte Sejfulla Malëshova, pas zhgënjimit të tij nga përvoja personale në BS.

Tashko e Malëshova ishin bashkëpunëtorë të afërt të Nolit. Komunist e jo social-demokrat ishte Nako Spiru, ndonëse pati fund tragjik nën presionin e Xoxes e të Enver Hoxhës. Kishte edhe idealistë midis komunistëve që më pas mund të jenë zhgënjyer, por kjo nuk e fshin veprimtarinë e tyre për përhapjen e komunizmit, as nostalgjinë e tyre të mëpasme për komunizmin. Bashkëpunëtorë të ngushtë të Qemal Stafës dëshmojnë se ai ishte penduar për rrugën që kishte nisur. Rasti i Qemal Stafës ilustron fare mirë vërtetësinë e një thënie të

Çerçillit: “Kush e ka lexuar Manifestin Komunist në moshën 18 vjeçare dhe nuk është bërë komunist nuk ka zemër. Kush e ka lexuar në moshën 25 vjeçare dhe është bërë komunist nuk ka tru”. Tani natyrisht edhe kjo shprehje ka humbur gjysmën e vlerës së vet pas dështimeve që pësoi komunizmi.

Fakti që shumë komunistë me emër ranë viktimë e spastrimeve të diktatorëve komunistë, nuk i nxjerr të viktimizuarit nga bota e komunizmit, as në aspektin e përkatësisë objektive, as në aspektin e përkatësisë së tyre subjektive.

Me aspektin psikologjik të çështjes se si komunistë të shquar bolshevikë gjatë spastrimeve staliniane pranonin akuzat e tmerrëshme e të pavërteta që u bëheshin si armiq e njerëz anti-parti janë marrë shumë studiues në Perëndim e në Lindje në kohë të ndryshme. Në revistën javore sovjetike “Kohët e reja”, botim frengjisht Moskë, nr1 viti 1990, fq. 42 shkruhet: “Përse garda e vjetër u suall në mënyrë të çuditshme; përse i pranuan akuzat?! Artur Kestleri dhe Solzhenicini shpjegojnë: ishin sigurisht torturat, dërmimi i paduruar; terrori moral, psikologjik; frika për të afërmit. Në këto rrethana të bësh akuza kundër vehtes ishte të sakrifikohesh. Dhe kjo nga njerëz që kishin kaluar nëpër burgjet cariste...por s’ishin më revolucionarë të rinj dhe ëndërrimtarë, por pleq të demoralizuar, të ngatërruar në labirintet e intrigës për pushtet, të ndërgjegjshëm për shembjen e idealeve. Nuk ishte koha e luftës së dritës kundër mbretërisë së errësisë. Stalini ishte i tyre”. A nuk e kemi parë e dëgjuar në sekuenca filmike të mbledhjes së Plenumit të KQ të PPSH edhe Kadri Hazbiun të shprehej “edhe po të arrestohem partia ime më arreston”, kur Enveri e kërcënoi me vënie prangash?

Kjo psikologji është shfaqur në sjelljen e të gjithë atyre që e kanë pësuar gjatë luftës gërryese brenda PKSH-PPSH, është vërtetuar me të gjithë ata që kanë pësuar dhe në çdo rast. Sa anëtarë të PPSH të persekutuar nga Enveri kanë dalë nga burgu më komunistë se ishin kur hynë? Pra vetëm eliminimi i shumë komunistëve të dëgjuar në Shqipëri nga Enver Hoxha nuk dëshmon aspak se ata nuk kanë qenë komunistë, por liberalë, viktime të një “feudo-komunizmi shqiptar islamik”. Likuidime të tilla janë një dukuri e jetës partiake dhe shtetërore në komunizëm. Këtë e dëshmon më së miri historia e çdo partie komuniste, e çdo pushteti komunist në çdo vend të botës, sidomos në BS, Kinë, Shqipëri, Jugosllavi, Francë. Enver Hoxha zbatoi ato praktika që zbatonte sllavo-komunizmi leninist-stalinist në Bashkimin Sovjetik. Po kështu ka ndodhur në hierarkinë komuniste në Kinë, në “komunizmin liberal” titist jugosllav.

Prandaj kot lodhet **“Ora e Shqipërisë”** të paraqesë likuidimet e bashkëpunëtorëve nga Enver Hoxha si tipar të “feudo-komunizmit shqiptar islamik”. Ata ishin imitim i praktikave të sllavo-komunizmit leninist-stalinian, ishin zbatim i mësimave të Miladin Popoviçit dhe Dushan Mugoshës.

Komunizmi sllavo-ortodoks shpallte armikun myslimano-nacionalist në Shqipëri

Si për inat të katoliko-centristëve të **“Ora e Shqipërisë”** që tentojnë ta paraqesin komunizmin si surrogato të myslimanizmit në Shqipëri, në “Gazeta Shqiptare” të datës 6 korrik 2001 është botuar një dëshmi shumë interesante për të kundërtën, për tërheqjen e ndërsjellë midis komunizmit e krishtëritimit edhe në Shqipëri.

Duke iu referuar kujtimeve të ish të burgosurit politik Agim Musta nga bisedat në burg me bashkëvuajtësin, intelektualin e njohur Gjergj Komnino, gazeta shkruan për ndodhi të kohës së LDB, kur Gjergji bashkë me Temo Mandilin ishin përgjegjës për agjitacionin e propagandën në shtabin partizan në Gjirokastrë. Komnino i ka treguar Mustës “Një ditë komisar i shtabit Shemsi Totozani na erdhi në zyrë dhe na dha një trakt për ta shaptilografuar. Unë i hodha një sy traktit dhe mbeta i tronditur nga ajo që ishte shkruar aty. Ai ishte shkruar në gjuhën mesjetare të kryqëzatave, sepse aty thuhej “ngrehuni ju o të krishterë të Dropullit, të Pogonit dhe të Vurgut dhe bjeruni agallarëve të Gjirokastrës, bejlerëve të Delvinës e të Libohovës, shushunjave myslimano-balliste që ju kanë thithur gjakun. Këmbanat e hakmarrjes kanë rënë. O sot o kurrë”.

Pra, në traktin e shkruar nga komunisti i rreptë Shemsi Totozani, i cili më vonë do ta pësonte po nga komunistët e rreptë si ai, kishte sajuar kategorinë armiqësore “myslimano-balliste (nacionaliste)” dhe me një frymë politike ku pulsonte vjersha e pararendësit të këtij komunizmi, Nolit, “ngrihuni e bjeruni, katundarë e punëtorë, që nga Shkodra gjer në Vlorë” u bënte thirrje të krishterëve grekofonë, jomyslimanëve, të ngriheshin e të bënin kasaphanë si në kohë kryqëzatash kundër myslihanëve. Që fanatikët katolikë të kuptojnë edhe më mirë se cili ishte Shemsi Totozani le të lexojnë ato që ka shkruar Prenk Gruda për të në “Ditari i një zemre të lëndueme 1937-1975”, botim i “Eurorilindja” Tiranë, vitin 1997, v.II. fq. 539, shënim i datës 21 gusht 1951 me titull “Me revole në tryezë”. Këtu tregohet se si nënministri i arsimit, komunisti Shemsi Totozani, nën mbikqyrjen e një këshilltari sovjetik, pra të një sllavo-komunisti dhe jo të ndonjë hoxhe nga ndonjë vend islamik, me revole mbi tryezën e punës e me të shara u njoftonte pushimin nga puna arsimtarëve shqiptarë me prirje nacionaliste.

Një ushtarak grek (për fat të keq në dorëshkrimin e përkthimit që kam unë mungon emri i tij dhe përkthyesi nuk jeton më) ka rrëfyer për takimet që ka zhvilluar nga fundi i LDB me të dërguarin nga Shqipëria, Dhimitër Fallo, i cili i pajisur edhe me letër nga Mitat Frashëri, ka zhvilluar bisedime për një bashkëpunim shqiptaro-grek kundër rrezikut të sllavo-komunizmit që po përparonte në rajon dhe për variantet e krijimit të një shteti greko-shqiptar. Greku përshkruan se si vazhdimisht u bëhej presion shqiptarëve të pranonin që Vorio-Epiri të aneksohej nga Greqia para se të vendosej për formën që do të kishte shteti i përbashkët. Bisedimet nuk çuan në asnjë rezultat, sepse grekët kishin planet e tyre. Në tërë shkrimin e këtij ushtaraku grek shprehet një mëri e madhe për myslimano-nacionalistët shqiptarë si “persekutues të grekëve” të Shqipërisë. Nuk është aspak rastësi ajo që mësojmë nga Komnino tani për traktin e komunistit gjirokastrit Shemsi Totozani për “luftë kryqtare” kundër “myslimano-ballistëve”.

Tregimi i Komninos vazhdon me fjalët që i kishte thënë Temos se ai kishte dalë për të luftuar pushtuesin dhe jo për të bërë luftë kryqëzatash. Kur Shemsiu vuri re se trakti nuk ishte bërë gati sipas porosisë së tij ai e lidhi me litar Komninon e futi në një ahur bagëtish dhe ky kishte rrezik të merrte plumbin nga “myslimani-komunist” si ndëshkim që Gjergji nuk kishte pëlqyer gjuhën e luftës së kryqëzatave në qoftë se nga Shtabi i Përgjithshëm partizan, me qendër në Labinot të Elbasanit, nuk do të kishte mbërritur në këtë moment urdhëri që Komnino të dërgohej atje për të shërbyer si përkthyes. Në Shtab Komnino pa se si urdhërat jepeshin nga Miladin Popoviçi, Dushan Mugosha, Vukmanoviç Tempo nëpërmjet Enver Hoxhës.

Por për katoliko-centristët e sotëm të Partisë Demokristiane, edhe këta shovinistë sllavë duhet të kenë qenë “komunistë islamikë”, sepse sot katoliko-centristët kanë për mision të bëjnë kryqëzatë propagandistike kundër myslihanizmit në Shqipëri që t'i shërbejnë Kristosllavizmit, sikurse i kanë shërbyer në kohën e LDB e më vonë komunistët internacionalistë shqiptarë sllavo-komunizmit shoven ndaj shqiptarëve.

Katolikocentrizmi anti-islamik shqiptar në shërbim të Kristosllavizmit

Ashtu si termi “katolikocentrizëm” që e kam huazuar nga studimi i Nexhat Ibrahimit edhe termi “Kristosllavizëm” është i huazuar.

Kësaj radhe huazimi është nga studimi i një të huaji, i titulluar “Thika e Vukut: Kosova, Golgota Serbe dhe radikalizimi i shoqërisë serbe”, botuar në faqet 133-141, të përmbledhjes në anglisht “Kosova, zëra kundërshtues për ndërhyrjet në Ballkan” përgatitur në SHBA nga Uilliam Xhozef Bakli dhe vënë në qarkullim në vitin 2000. Në këtë studim autori Majkëll A. Sells ka një trajtesë me nëntitullin “Kristosllavizmi dhe versionet mitike të historisë klasike”.

Trajtesa e Majkëll A. Sells të bën edhe më tepër përshtypje po ta nisësh studimin e mesazhit të saj nga një “fakt shqiptar” i vërtetuar para disa vitesh. Në vitin 1992 në Kajro është botuar përkthimi në gjuhë shqipe i Kuranit, bërë nga dietari fetar H. Sherif Ahmeti, nga Kosova. Në parathënien e shkurtër, më pak se një faqe, të këtij botimi të shkruar nga Ahmed Raif, është

edhe fjalia “Komunizmi u përpoq të shkatërrojë çdo gjë që ka lidhje me trekëndëshin islamik në Ballkan” (është fjala për Bosnjen, Shqipërinë, Kosovën), por “gjurmët islame mbetën të qarta”. Është edhe fjalia “shqiptarët arritën ta dëbojnë komunizmin, kur më vonë doli në skenë djalli i mallkuar - djalli i përgëzimit (pagëzimit) në krishterizëm”. Këto fjali, sidomos kjo e dyta diku shkaktuan alergji të madhe anti-islamike sa që puna shkoi deri në reagime nga pushtetarët shqiptarë të asaj kohe dhe nga drejtuesit e Bashkësisë Islame të Shqipërisë që urdhëruan të grisej faqja me hyrjen në gjuhën shqipe para se të viheshin në qarkullim kopjet e Kuranit në shqip për besimtarët myslimanë.

Edhe atëherë ishte e qartë, por rrjedhat e ngjarjeve gjatë gati 10 viteve kanë nxjerrë në shesh më dukshëm, se në dy fjalitë e cituara nuk kishte asgjë për t'u alarmuar, asgjë provokuese ndaj dikujt të një feje tjetër. Ngjarjet përkundrazi kanë provuar se “puna e djallit” në Shqipëri për të futur sherrin e konvertimit të myslimanëve në të krishterë kishte qenë shumë më e organizuar, më e pabesë, më e dëmshme se sa mund të kuptohej nga fjalitë që u shpallën dhe u dënuan me grisje flete si heretike. Ngjarjet kanë dëshmuar se në botimet e predikimit e krishtera dhe në politikën e veprimtarinë agjenturore që bëjnë mekanizma të huaja politike e fetare të krishtera në Shqipëri kundër Islamit është derdhur mllef e bërë veprimtari e hapur në përmasa marramendëse.

Në kuadër të kësaj veprimtarie duhet parë edhe mercenarizmi anti-islamik i katolikocentrizmit sipas frymëzimeve dhe interesave të kristosllavizmit. Komunizmi sllavo-ortodoks në Shqipëri e luftoi myslimanizmin edhe më shumë se në Jugosllavi apo në Bashkimin Sovjetik për të kryer shërbesat e tij internacionaliste. Kurse tani katolikocentrizmi po bën një shërbestari edhe më të keqe me luftën kundër Islamit ku motivimin ideologjik po e zëvendëson me një motivim fetar. Katolikocentrizmi që përçojnë demokristianët po bëhet një faktor po aq regresiv sa ateizmi komunist në fushën e respektimit të vlerave e të tolerancës fetare në Shqipëri. Kjo luftë e posaçme kundër Islamit në Shqipëri nuk është vetëm rrjedhojë e përçarjeve të fanatikëve katolikë të paditur, por është një veprimtari e sofistikuar politiko-fetare që nis jashtë kufinjëve të Shqipërisë.

Shfaqjet më të egra të kësaj dukurie i kemi parë gjatë luftërave që shpërtheu nacional-shovinizmi serb në Bosnje e Kosovë dhe po i shohin këtë verë në pogramet antishqiptare e anti-myslimane të sllavomaqedonëve në Maqedoni. Përveç shkaqeve gjeopolitike, gjeostrategjike, historike, etnike këto shfaqje të shëmtuara janë të nxitura edhe nga urrejtja që ka krishterimi sllavo-ortodoks kundër myslimanizmit në Ballkan.

Si dhe ku i gjen Sells gjurmët e kristosllavizmit

Majkell A. Sells duke i studiuar këto dukuri ka formuluar e përpunuar edhe konceptin mbi “Kristosllavizmin”, si një dukuri e veçantë politiko-fetare.

Sipas Sells “reagimi i sotëm i serbëve ndaj historisë së tyre mbisundohet nga mitizimi i osmanëve, turqëve e myslimanëve si një forcë thjesht djallëzore” (fq. 135).

Ashtu si Anzulloviç në studimin “Serbia qiellore” edhe Sells e shpjegon këtë dukuri duke ndjekur një vijë vazhdimësie nga poema e Njegoshit “Kurora e maleve” (1859) tek romani i kohës së sotme i shkrimtarit politikan, Vuk Drashkoviç, me titull “Thika” që bën fjalë për ngjarje të kohës së LDB dhe deri tek “studimet shkencore” të biogjenetistes politikane Biljana Pllavshiç, ish-kryetare e Akademisë së Shkencave Natyrore në Sarajevë, udhëheqëse e lartë e serbëve në Bosnje dhe përfundimisht kontigjent i Gjykatës Ndërkombëtare për krimet e luftës në Hagë.

“Kurora e maleve”, kushtrim e fetishizim i luftës kundër myslimanëve, kulmon me festimin e zhdukjes së tyre e të gjurmëve. Sells e ka analizuar saktë efektin e sotëm të kësaj poeme kur përmend se ajo u ribotua edhe u shpërnda në kohën e përgatitjeve për festimin e 600 vjetorit të betejës së Kosovës, nga ku nisi ngjitja e Milosheviçit në pushtet.

E njëjta frymë anti-islamike shprehet edhe në romanin e Vuk Drashkoviçit që ka pretenduar e pretendon të jetë figurë qendrore e politikës në Serbi. Koncepti i “kristosllavizmit” në këto shkrime shprehet nëpërmjet “besimit se sllavët nga vetë natyra e tyre janë të krishterë” dhe se “çdo kalim në një fe tjetër përbën poshtërsi, grykësi”. Sells ka theksuar se “shkrimtarë të shekullit XX (katolikë dhe ortodoksë) e kombinuan këtë ideologji të kristosllavizmit me ide raciste. Konvertimet ishin në të njëjtën kohë tradhëti racore dhe transformim racor”, që do të thotë se të konvertuarit përjashtoheshin nga bashkësia e njerëzve gjakut të së cilës i përkisnin. Në poemën e Njegoshit e pësojnë sllavët e myslimanizuar (edhe në Kretë pas bashkimit të saj me Greqinë u shkatërrua dhunshën bashkësia islamike që përbëhej nga grekë të islamizuar).

Kombinimin e krishtërit me teza raciste e ka bërë në mnëyrë më vulgare biogjenetistja Biljana Plavçiç sipas së cilës “Islamin e përqaftuan ata që kishin material gjenetik të deformuar. Dhe tani sigurisht tek çdo brez pasardhës ky gen bëhet më i përqëndruar. Ai bëhet gjithnjë më i keq. Ai shpreh dhe dikton stilin e tij të menduarit e të sjellurit që është rrënjësor në gene”. Gazetarët e “**Ora e Shqipërisë**” kanë thënë të njëjtën gjë, sidomos Mark Bregu kur i drejtohet myslimanit Bujar Shehu, shqiptar si dhe Marku se ai duhet të shkojë diku në Azi, pasi nuk ka më gen shqiptar përderisa është mysliman. Marku mund të bëhej një ushtar shumë i mirë i Biljana Plavshiçit për të luftuar në Bosnje genet e prishura nga myslimanizimi në fe.

Pasues të Njegoshit, Drashkoviçit e Plavshiçit edhe në Shqipëri

Në Shqipëri kemi dëgjuar herë pas herë pikëpamje si ato që shprehen nga bartësit e kristosllavizmit se gjoja shqiptarë mbetën vetëm ata që qëndruan katolikë, që nuk u bënë myslimanë, ndërsa ata që u bënë myslimanë tradhëtuan fenë dhe racën dhe pasardhësit e tyre deri sa të mos konvertohen përsëri në krishtërim janë të tjetërsuar në gen e në racë.

Këto mendime të mbrapshta i gjejmë edhe tek intelektualë shqiptarë, sidomos ata që ndjekin shkollën laiko-fetare të Zef Mirditës e Lush Gjergjit në Kosovë, tek Kadareja, Tozaj, Plasari, demokristianët e të tjerë në Shqipëri, pa folur për fanatikët që i lëshojnë pikëpamje të tilla si lopa bajgën nëpër biseda të rastit.

Mirëpo studimi i Sells na tregon se këto janë pikëpamje dhe politikë e kristosllavizmit jo përralla e lajthitje të kota. Sells na tregon se Drashkoviçi në romanin vet “demonizon kroatët e myslimanët si sadistë që janë nën nivelin e qenies njerëzore. Ai i portretizon myslimanët si serbë që kanë tradhëtuar racën dhe pushtimin nazist si kthim të sundimit mysliman dhe gjendjen nën nivelin njerëzor të myslimanëve e lidh me kryqëzimin e Krishtit”. Kur njihesh me këto vlerësime të Sells të bëhet e besueshme se disa pjesë të shkrimit të Mark Bregut kundër myslimanizmit janë perifrime vulgare të mendimeve të romanit të Vuk Drashkoviçit.

Pra, ofensiva që bëhet kundër myslimanizmit në Shqipëri ujin e çon në mullirin e kristosllavizmit, siç na e përshkruan Sells. Me anti-islamizmin e tyre katoliko-centristët shqiptarë vënë në punë mullirin e kristosllavizmit, i bëjnë këtij atë shërbim që i bënte komunizmi shqiptar sllavo-komunizmit.

Sells ka shkruar edhe këtë “Intelektualët dhe akademikët serbë në Beograd shkruajnë hapur se myslimanët e sotëm i kanë duart e lyera me gjakun e martirëve serbë e të Krishtit Princ-Llazar”. Të njëjtën gjë si këta serbë bën edhe Mark Bregu kur qorton Bujar Shehun dhe të tjerë myslimanë në Shqipëri që nuk respektuan gjakun e shenjtë të Millosh Kopiliqit, njeriut që pas Lllazarit vjen i dyti për rëndësi në legjendën serbe. Edhe Mark Bregu me shokë sipas frymëzimit që u japin akademikët e Beogradit përpiqen të bëjnë pa pushim zhurmë se myslimanët e sotëm shqiptarë duhet të ndjehen mëkatarë se i paskan duart me gjakun e të krishterëve që kanë derdhur myslimanët nëpër luftëra dhe këto duar u lakan vetëm duke u kthyer sërish në të krishterë.

Serbët e trullosur me kristosllavizëm kur merrnin pjesë në demonstratat e udhëhequra nga Vuk Drashkoviçi kundër presidentit Milosheviç thërrisnin si fyerjen më të rëndë “Sllabo është

turk”, “Sllobo është ustash”. Edhe Mark Bregu me shokë në Shqipëri si fyerje më të rëndë po përdorin “je mysliman”. Kush ua ka futur në gjak e në tru këtë metodë fyerjesh serbe?! Ku mund t’i çojë vallë ata kjo mënyrë të fyeri sipas modelit serb?! Kur ata u thonë myslimanëve shqiptarë “shkoni po deshët në Azi”, siç u thonin dikur serbët shqiptarëve të Kosovës “shkoni po deshët në Shqipëri” a kanë menduar se mund të marrin si përgjigje pyetjen “po ju a keni menduar se ku e keni vendin nëse nuk doni të bashkëjetojmë në këtë truall?”.

Me një fjalë, në Shqipëri pas katolikocentrizmit ka shumë kristosllavizëm. Mos ndikojnë për këtë edhe disa klerikë që vijnë nga jashtë kufinjve të Shqipërisë londineze?!

Kleri katolik e ka pësuar nga sllavo-komunizmi jo nga “komunizmi islamik”

Ka studiues që mendojnë se edhe ashpërsia e persekutimeve kundër klerit katolik në Shkodër është bërë me udhëzim të komunistëve jugosllavë në kuadër të grindjes së vjetër të ortodoksisë me katolicizmin.

Armiqësia midis dy degëve të krishtërimit është gjë e njohur, sikurse është e njohur edhe egërsia e intrigave dhe përplasjeve të tyre për mbisundim në hapësirat ballkanike e shqiptare. Në Greqi Papën e paraqitën si djall me brirë nëpër muret e Athinës gjatë vizitës së paradokohshme. Kisha ortodokse e Ukrainës mobilizoi mijëra njerëz të protestonin kundër vizitës së kreut të Vatikanit me ftesë të presidentit ukrainas në qershor 2001.

Anastas Janullatosi, prifti grek me të cilin fanatikët katolikë shqiptarë duan të bëjnë aleancë kundër Islamit në Shqipëri, mburret se “ortodoksët më mirë e më herët se katolikët njohën Islamin dhe iu kundërvunë” se “me të krishterët e Perëndimit myslimanët për herë të parë u njohën në kushtet e betejave të kryqëzatave”. Janullatosi ua heq veshin katolikëve kur shprehet “njëkohësisht ortodoksët janë të detyruar t’u kujtojnë vëllezërve të tyre të Perëndimit se me veprimet e tyre në të kaluarën kishin plagosur marrëdhëniet e të krishterëve dhe myslimanëve...kryqëzatat e dobësuan Perandorinë Bizantine, provokuan ndezjen e fanatizmit mysliman, thyen ekuilibrin e bashkëjetesës e të harmonisë që ka qenë kultivuar në periudhën e Abasidëve. Për më tepër, i hidhëruan aq shumë të krishterët e Lindjes sa që të vuajturit ortodoksë në shekullin XV të preferojnë Gjysëm-Hënën në vend të “mbrojtjes nga Roma” (A. Janullatos “Dialogu i të krishterëve me Islamin. Një pikëpamje”).

Ashpërsia e diktaturës komuniste në Shqipëri nuk ka asnjë shenjë ndikimi nga myslimanizmi, por të gjitha tiparet e diktaturës bolsheviko-staliniste të zbatuar në Bashkimin Sovjetik. Deri në vitin 1948 diktatura e egër komuniste në Shqipëri ushtrohej nën drejtimin e përditshëm të komunistëve jugosllavë dhe të vegëlës së tyre kryesore Koçi Xoxes. Pastaj nën drejtimin e komunistëve rusë. Më vonë diktatura komuniste enveriste u ashpërsua duke huazuar metodat ekstremiste të komunizmit kinez të kohës së revolucionit kulturor.

Atëherë ku kanë zbuluar ndikime islamike “**Ora e Shqipërisë**” dhe “teoricienti” i saj kryesor i çështjeve komuniste Mark Bregu në veprimtarinë e diktaturës komuniste në Shqipëri? Apo vetëm në direktivat që ka lëshuar çifti francez Shanse në librin “Shqipëria ose logjika e dëshpërimit” dhe në pickimet e fanatikëve të shkollës katolike zagrebase?!

Bashkëshortët francezë Shanse në librin e tyre kanë synimin të provojnë se “Në Shqipëri komunizmi ishte shqiptar...” (fq.6), por bëjnë edhe konstatimin që ia ngatërron pak punën Mark Bregu “Në Epir rezistenca komuniste greke u bë mjaft e fuqishme dhe nuk është e rastit që në Jug komunistët shqiptarë qenë më të fortë (fq.20) ...Në fakt pjesa gege e Veriut tradicionalisht është shumë më armiqësore ndaj komunizmit se sa Jugu toskë” (fq.175). Por nga dëshira për të fallsifikuar sa më shumë realitetet në Shqipëri dy francezët i bëjnë lëmsh shumë konstatime e arsyetime. Sipas tyre “Në Shqipëri nacionalizmi dhe komunizmi ishin të pandarë” (fq.52), por “nacionalizmi i Partisë Komuniste ishte më të vërtetë shumë abstrakt” (fq.55). Veç kësaj “Edukimi nationalist i dhënë nga komunistët dështoi”, sepse “ndryhe nga ç’kanë namën shqiptarët, që u vjen turp nga vendi i tyre, nuk janë aspak nationalistë”(fq.57). Nga Shansët e Francës duhet të jetë frymëzuar edhe Paskal Milo që në libërthin mbi mitin e

“Shqipërisë së madhe” që ua ka shpërndarë kohët e fundit diplomatëve të huaj në gjuhët angleze e franceze betohet pa pushim se në Shqipëri nuk paska nacionalizëm.

Sipas çiftit Shanse “...shqiptarët me përjashtim të bektashinjëve dhe të një pjese të ortodoksëve të jugut në kohën e çetave nuk kishin një ndjenjë të vërtetë përkatësie kombëtare. Ata përcaktoheshin në radhë të parë nga feja e tyre (f,47)...ortodoksët pranonin më lehtë fjalët e huazuara nga greqishtja, katolikët përdornin me tepriçë fjalë me origjinë latine, ndërsa myslimanët qëmtonin në turqishten, arabishten dhe persishten”. (fq.50).

Kështu që sipas këtyre francezëve kaq “të mençur”, del që termat e komunizmit shqiptarët t’i kenë marrë nga greqishtja e gjuhët neolatine, pra pa ndonjë kontribut të myslimanëve, sepse në gjuhën ideologjike të komunizmit nuk kemi huazime arabe, turke, persiane si për punët e kuzhinës, orënditë e shtëpisë etj. Mark Bregu dhe **“Ora e Shqipërisë”** mbase do të kujtohen ndonjë ditë të studiojnë **“Buletin Jeshil”** që nxirte në Shkodër grupi komunist i Zef Malajt dhe të na japin ndonjë tablo të qartë si ka hyrë terminologjia komuniste në gjuhën shqipe. Që të mos na ngatërrojnë më kaq shumë “francezët e mençur”.

“Komunizmi islamik” shqiptar si “armiku i ri i përbashkët” i ballkanasve

Nuk është pra vetëm një mani e disa shqiptarëve në Shqipëri që e kanë bërë të modës t’u bien natë e ditë borive të alarmit kundër rrezikut imagjinar të myslimanizmit e të komunizmit.

Kjo modë vjen përsëri më shumë nga jashtë Shqipërisë, sikurse ka ardhur edhe në të kaluarën. Janë të njëjtat rryma politike që kanë synuar të ngrenë të krishterët kundër myslimanëve në Shqipëri që të përçajnë, të dobësojnë dhe shpartallojnë kombin shqiptar. Janë të njëjtat rryma politike që gjithmonë përpiqen të gjejnë një armik të përbashkët të shqiptarëve, sllavëve, grekëve sa herë që shqiptarët ndeshen me fqinjët për çështjen e tyre kombëtare..

E përmendëm se si Koshtunica (dhe greko-amerikani Geixh) përpiket tani që t’i kundërverë shqiptarët sipas dallimeve fetare e krahinore. Intriga të tilla janë bërë edhe më parë.

Robert C. Austin në librin për **“Shtigjet e panjohura drejt Fan Nolit”** në faqen 46 vë në dukje: “Jugosllavët kërkonin të manipulonin minoritetin katolik në Veri duke vënë në dukje epërsinë e parisë myslimane në Tiranë”. Në faqen 49 shton *“Delegati jugosllav Jovanović thoshte para Lidhjes së Kombeve se me krijimin e Republikës së Mirditës, statusi i Shqipërisë si shtet, si anëtare e Lidhjes vihej në dyshim”*. Fan Noli detyrohej të mbrohej para Lidhjes së Kombeve duke theksuar se nuk kishte vend tjetër në botë me më pak fanatizëm fetar se sa në Shqipëri!”

Me ndihmën e ushtrisë jugosllave prijësi katolik i Mirditës katolike kërkonte të krijonte një republikë të pavarur nën kujdesin e Jugosllavisë. Justifikimin e gjeti për shkëputjen nga Shqipëria ishin prirjet xhonturke të qeverisë së Tiranës dhe qëndrimi i saj ndaj fesë katolike. Tani akuzohet “komunizmi islamik” si bejlerët dikur.

Në librin e Pal Doçit **“Mirdita vatër e qëndresës antiosmane”** (Tiranë 1999) ka me bollëk material për të kuptuar si është luajtur historikisht nga fuqitë e huaja me idenë e një “republike katolike” në malësitë shqiptare dhe si disa veprime politike propagandistike të sotme janë ripërtëritje e asaj fryme separatiste lokaliste; se si antiosmanizmi po ringjallet gradualisht jo thjesht për erudicion historik, por edhe për t’u përdorur në kuzhinën e një politike të keqe të ditës në Shqipëri. Madje kalohet edhe në zbulime të dukurive negative si cubnia duke e paraqitur si “formë të qëndresës antiosmane” që është gati njësoj si të tentosh sot të thuash se grabitjet me maska nëpër rrugë i shërbejnë kultivimit të ndjenjës së lirisë e të demokracisë kundër trashëgimisë së *“komunizmit islamik”*.

Për rreziqet e spekulimeve me antimyslimanizmin (që në kushtet tona përfshin edhe spekulimin me antiosmanizmin) në çaste e rrethana të caktuara ka qenë i detyruar të shprehet edhe Ismail Kadareja. Në një intervistë në *“Rilindja”* (javore) 7-13 korrik 1996 ai ka thënë *“... sipas mendimit tim, zhvillimi më kërcënues tani është alternativa e rreme midis*

Islami dhe Krishtërimin ortodoks e cila në Jugosllavi është përdorur shpesh. Kjo ka krijuar një rrëmujë absurde. Të krishterët janë të përcarë për shkak të kësaj situate të pabesueshme në Ballkan, ku krimet përligjen përmes religjioneve. Islami është religjion botëror që duhet respektuar si të gjitha religjionet. Nuk duhet provokuar vazhdimisht. Natyrisht Islami nuk bën t'i provokojë të tjerët".

Në një rast të mëparshëm Kadare është shprehur: *"Le ta them haptas: serbët nuk do të guxonin kurrë të ndërmerrnin aventurën e tyre në Ballkan pa shpresuar se bota e krishterë do ta miratonte heshturazi aksionin e tyre si aksion antiislamik, gjë që edhe ndodhi në fakt. Gabimi strategjik i Perëndimit të sotëm do të jetë në qoftë se i obseduar pas teorisë së rrezikut islam, si rrezik imediat do të harrojë rreziqe të tjera në këtë botë".* (Gazeta "Intervista", "Rilindja" 21.1.1994). Zhvillimet në Maqedoni po tregojnë drejtësinë e këtij paralajmërimi të Kadaresë. Përfundimi e ka neglizhuar rrezikun rus-pansllavist pas disfatës së sllavo-komunizmit. Mirëpo tani është po ai kërcënim si në kohën e sllavo-komunizmit që turbullon gjendjen në Maqedoni. Kurse demokristianët e Shqipërisë lëshojnë alarme kundër "komunizmit islamik".

Vlera e fjalëve të cituara më sipër të Kadaresë qëndron së pari në atë që i thotë një person, i cili është përpjekur për shumë kohë t'u mbushte mendjen shqiptarëve se fajin për fatkeqësitë e tyre të sotme e paskan paraardhësit e tyre që pranuan Islamin. Ky Kadare që këshillon *"të mos provokohet vazhdimisht Islami"* (nganjëherë nuk prishka punë), që e pohon se në emër të luftës kundër Islamit armiq të shqiptarëve justifikojnë krimet e tyre, ka lëshuar fatkeqësisht edhe mendime e fjali të tilla si: *"Shqipëria po e paguan shtrenjtë islamizimin e saj.... shqiptarët duhet të vuajnë nga një ndjenjë faji që të korrigjohet sa më parë,..... shqiptarët nuk kanë qenë kurrë islamikë.... ekstaza islamike që kanë disa shqiptarë për mendjen time është një ekstazë në thelb antishqiptare, pavarësisht se ata mund të hiqen si patriotë të mirë, por objektivisht janë kundër Shqipërisë".*

Me këto mendësi Kadare shkon deri tek përfundimi: *"në qoftëse do të kërkonim një fundamentalizëm ky do të ishte fundamentalizmi katolik më i logjikshëm dhe më i përshtatshëm"* (Cituar nga broshura e Rexhep Hoxhës "Nuk është ashtu" Prishtinë 1996, fq.6). Është e kuptueshme që fanatikët katolikë duke përfshirë dhe politikanët e gazetarët e Partisë Demokristiane, do ta ngrenë në qiell "shenjtin" e tyre, Ismail Kadare që përligj fundamentalizmin katolik.

Prandaj **"Ora e Shqipërisë"** gjen guxim të shkojë dhe pak më tutje e të shkruajë se shqiptarët nuk kanë parë ndonjë të keqe nga sllavo-komunizmi dhe se armiku i tyre qenka vetëm "komunizmi islamik", si politikë e ideologji dhe Islami, si fe. Pra kemi të bëjmë me një variant politiko-fetar të tezës politiko-historike të shkollave sllavo-greko-bizantine se armiq të shqiptarëve nuk janë fqinjët sllavë e grekë, por dikush tjetër më larg e sidomos osmanët dhe turqit e myslimanët sot. Pra "komunizmi islamik" i duhet dikujt që të sajtojë një armik të ri të përbashkët të paqenë për shqiptarët, sllavët, grekët.

Katolikonzentrizmi është aventurë dështake

Këtë djallëzi politiko-fetare Mark Bregu mundohet ta servirë edhe me ambalazh tërheqës folklorik kur thotë se *"shqiptarët e vërtetë"* nuk pranuan myslimanizimin dhe morën malet e u rrasën nëpër shpella *"të jetojnë më mirë me ujkun, por jo kurrë me turkun"*.

Sado t'u bjerë çiftelisë e lahutës së fanatizmit katolik sot Marku nuk ia mbush mendjen kujt se shqiptarë qenë vetëm ata që shkuan të jetojnë me ujkun dhe se shqiptarë paskan mbetur vetëm pasardhësit e tyre që qëndruan në fenë katolike. Ata janë shumë të pakët në trojet shqiptare për të pretenduar se ata qenkan kombi shqiptar, se gjithë të tjerët që flasin shqip por që nuk janë katolikë qenkan bastardë e dobiçer, apo aziatikë.

Edhe pse Markut mund të mos i pëlqejë sot paraardhësit tanë e patën fat historik të jetonin 500 vjet nën "turkun" e "me turkun" fillimisht si të krishterë, pastaj shumica si myslimanë. Është e vërtetë se edhe gjaku është trazuar. Do apo nuk do Marku ai që sot është e njihet për

komb shqiptar nuk përbëhet më vetëm nga ata që shkuan të jetojnë me ujkun, por në shumicë dërrmuese nga ata që bashkëjetuan me turkun në një perandori. Kjo është gjë që nuk zhbëhet dot më.

Është një libër i mrekullueshëm i titulluar “**Miftar Spahija, korifeu i Lumës**”, ku autori, Hasan Hasani nga Prishtina, ka paraqitur jetën, rrëfimet e mendimet politike të profesorit të letërsisë në një universitet amerikan, të diplomuarit për letërsi në Torino në vitin 1939, antifashist e antikomunist i emigruar në SHBA. Profesor Spahija ka shpjeguar me qartësinë e saktësinë më të madhe përse shqiptarët pranuan besimin islam si domosdoshmëri historike të ruajtjes së identitetit; si shqiptarët u myslimanizuan por nuk u turqizuan; si ata shqiptarë myslimanë luftuan për komb e atdhe edhe kundër sundimit të bashkëfetarëve të tyre.

Për këtë kanë shkruar edhe shumë autorë të tjerë. Edhe Pal Doçi në faqen 174 të librit “**Mirdita vatër e qëndresës antiosmane**” shprehet qartë e me vërtetësi se “Stambolli përdori masa e rrugë të ndryshme e të veçanta lufte për nënshtrimin e malsive, të cilat gjatë gjithë periudhës së pushtimit osman të Shqipërisë “*mbetën vatra të lirisë e të kombësisë shqiptare*”. Malsorët trima u bënë një nga forcat lëvizëse të lëvizjes çlirimtare në vitet 30-70 të shekullit XIX duke u dhënë kryengritjeve popullore forcë dhe shpirt luftarak”.

Kurse gazetarët e Partisë Demokristiane i bëjnë jehonë asaj rryme të mprashtë “intelektuale” e klerikaliste që përpiqet të provojë se vetëm ata që mbetën katolikë nëpër malsi mbajtën shqiptarësinë, madje vetëm ata që paskan shkuan të jetonin me ujkun e jo me turkun. Fanatizmi fetar, por më shumë një qëllim i caktuar politik i shtyn këta njerëz në absurditete të tilla. Serbët e kanë mani të akuzojnë shqiptarët se bashkë me turkun kanë shtypur sllavët e krishterë. Urrejtja e Markut për “turkun” nuk ka dallim nga ajo e serbëve. Duket që ai ka shumë bezdi të jetojë në një shtet, në një qytet me shqiptarë myslimanë. Por tani në kohët moderne nga kjo bezdi nuk shpëton dot as duke shkuan në mal të jetosh me ujkun. Marku mbase ëndërron që të jetojë me shkaun apo latinin dhe jo me “turqit e rinj” të Shqipërisë, por sa kohë të jetë në Shqipëri do ta ketë të pamundur ta realizojë këtë ëndërr.

Para disa muajsh disa “*intelektualë të zgjuar*” shqiptarë na propogandonin një federatë malazezo-shqiptaro-maqedone duke thënë se shqiptarët me malazezët e maqedonët merren vesht lehtë për bashkëjetesë, se kanë origjinë të përbashkët. Tani janë “*akadhemykët*” e Shkupit që sajojnë plane për të prishur edhe atë “*bashkëjetesë*” që ka ekzistuar, sepse shqiptarëve e maqedonëve “*nuk u puqet karakteri*”. Marku është i dënuar të jetojë bashkë me myslimanë shqiptarë, edhe sikur këta, sipas analizave që bën Marku, të dalin “aziatikë”. Marku nuk do të gjejë dot shpellë ku të zhduket.

Nëse Marku e soji i tij nuk e ka aq shumë hallin e sikletin tek gjaku shqiptar i trazuar me gjak osman por tek feja, dhe është gati t'i pranojë “*aziatikët e Shqipërisë*” po të bëhen “*katolikocentristë dhe eurocentristë*”, atëhere i duhet kujtuar se edhe ai vetë nuk është veçse një fe-aziatik, sepse edhe krishterimi si myslimanizmi nga Azia ka ardhur.

Edhe për këtë aspekt të problemit janë bërë diskutime para se të kujtohet ose të ngarkohet Marku të shkruajë në gazetën partiake të Zef Bushatit. Që të mos bëjnë shumë gafa propagandistët e partisë katolike duhet të lexojnë shkrimet e studiuesit nga Kosova, Nexhat Ibrahim, të përmbledhura në librin “Islami në trojet iliro-shqiptare gjatë shekujve”. Duke njohur më mirë të vërtetat këta do të kuptojnë përse prifti katolik Gjergj Fishta i këshillonte malsorët të rrinin “*njitë me Mbret t' Stambollit, për me i bamun ballë Nikollit*” dhe asnjëherë nuk u ka thënë malsorëve “*gëzohuni për shpellat e Malit t'Zi, për inat të myslimanëve osmanlli*”.

Historia mbetet ashtu siç është bërë

Fanatikët katolikë e kanë çarë me kohë daullen duke i rënë pa pushim avazit se shqiptarët u kthyen në myslimanë me dhunë e shtrëngim. Sado ta vërvisin topuzin e tyre shkruarit e “**Ora e Shqipërisë**” këtë daulle mund ta dëgjojnë vetëm ata dhe ndonjë shurdh që i buçasin veshët nga marshet e fanatizmit fetar katolik.

Sipas “historishkruesit” Mark Bregu ekzistuan me qindra fakte që vertetojnë se 90% e shqiptarëve u islamizuan me dhunë e nën terror antinjëzor. Studiuesi nga Kosova, Nexhat Ibrahim, ka vënë në dukje se edhe prijës fetarë në Kosovë si Dom Lush Gjergji, Dom Shan Zefi apo edhe intelektualë katolikë e myslimanë i përmbahen rrymës së katolikocentrizmit dhe trillimeve të Pjetër Bogdanit për islamizimin me dhunë, të shqiptarëve. Ndonjë si Engjëll Sedaj shpall që deri emrat “shqiptar” e “Shqipëri” qenkan të imponuar me dhunë nga Perandoria Osmane. Sipas Dom Lush Gjergjit “ sundimi osman kishte si qëllim zhdukjen e shqiptarëve si popull”.

Kujt dhe përse mund t'i shërbejnë thënie të tilla spekuluese sot kur dihet se populli shqiptar është shëndoshë e mirë, megjithëse u islamizua?! Për të vrarë mendjen është se çfarë mund të ndodhte sikur të mos ishte islamizuar. E ka thënë me vend Nexhat Ibrahim se “ historinë duhet ta shikojmë si ka qenë jo si kemi dashur të ketë qenë” (fq. 218)

Ua ka ditur mirë hallin e nevojën fanatikëve si Mark Bregu shtëpia botuese “**Foenix**” në Shkodër që ka botuar në shqip, 100 vjet pas botimit në Francë “**Kujtime nga Shqipëria e Epërme**” të konsullit francez A. Degrand. Koli Xoxe në një vështtrim kritik për këtë libër botuar në “**Tema**” të datës 3 qershor 2001 e ka theksuar se Degrand-i mendonte që shqiptarët u bënë myslimanë me shtërngim. Zyrtari francez, por si duket jo studiues i mirëfilltë, do të bënte punën e tij (ndonëse libri ka shumë vlera njohëse për gjendjen e Shqipërisë në atë kohë). Fanatikët katolikë do të gjejnë edhe tek francezë të kohës sonë një rëz që do t'u japin argumenta. Por nuk mungojnë edhe francezë që kanë bërë konstatime që i thartojnë shumë fanatikët katolikë. Mbas ndonja 100 vitesh të tjera mund të dalin fanatikë të rinj katolikë që të kënaqen me librin e çiftit Shanse për Shqipërinë, siç kënaqen të sotmit me kujtimet e Degranit.

Me përjashtim të ndonjë shkruesi spekulues autorët e librave e të studimeve serioze provojnë se Perandoria Osmane nuk ua ndërronte me dhunë fenë popujve të nënshtruar prej saj. Përkundrazi, në Europën e krishterë deri në mesjetën e vonë zbatohej rregulli “*cujus regio, ejus religio*”, që do të thotë njerëzit merrnin fenë që kishte sundimtari i tyre.

Më është dashur gjatë viteve të kaluara të citoj mjaft autorë të dëgjuar për islamizimin vullnetar të shqiptarëve . Autori amerikan Edvin Zhak, p.sh. në librin “**Shqiptarët**” vumi i parë, botim shqip në Tiranë në vitin 1996 ka një kapitull të tërë, të XX, mbi shkaqet e islamizimit të shqiptarëve. Madje ai nuk e ka qejf këtë islamizim dhe nuk ka lënë mundësi pa shfrytëzuar që të thotë se ka patur dhe përdorim dhune. Por pranon se në tërësi islamizimi i shqiptarëve ishte proces i vullnetshëm i tyre. Edhe pse Marku e gazetarët e “**Ora e Shqipërisë**” mund të protestojnë se po u rekomandoj librin e një autori mysliman e shoh të nevojshme të përmend përsëri librin e vlefshëm të Nexhat Ibrahimit për ata që nuk duan të bëjnë gafa në perceptimin e mënyrës të myslimanizimit të shqiptarëve, në të kuptuarit e rëndësisë e rolit të këtij myslimanizimi në jetën e kombit shqiptar dhe sot.

Ibrahimi u është referuar një rëzve të shquar të kohërave të ndryshme si mendimtari Volter (antiislam i njohur), historiani i famshëm Zhibon, shkrimtari Blasko Ibanjez, filozofët Gustav le Bon, Frederik Engels, Rozhe Garodi, mendimtarit tonë të madh por ende pak të njohur, Sami Frashëri që kanë argumentuar se Islami është përhapur nëpërmjet pranimi vullnetar kudo, në sajë të epërsive që ofronte në shumë fusha, madje edhe fushatat e pushtimit ushtarake vetëm kanë krijuar terren për përhapjen e Islamit por nuk e kanë rrënjësuar atë në shpirtin e mendjes e njerëzve. Mendimi i Rozhe Garodisë është se “*fuqia e armëve mund të shkatërrojë por jo ta krijojë një kulturë*”.

Në librin e Nexhat Ibrahimit (fq.228) është cituar pohimi i studiuesit serb Vladislav Shkariq : “ *Kalimi në fenë islame ka qenë tolerant në pikëpamje fetare dhe rrallë janë detyruar të krishterët të kalojnë në fenë islame. Të krishterët e kanë ndërruar fenë vullnetarisht. Me forcë janë islamizuar fëmijët e krishterë të marrë jeniçerë*”. Përse vallë Mark Bregu me shokë janë më të interesuar se një studiues serb të bëjnë të besueshme se të krishterët shqiptarë janë myslimanizuar me forcë?! Vetëm se duhet t'i shërbejnë politikës së katolikocentrizmit për “*vetpërcaktim të ri fetar të shqiptarëve*” (sikurse e ka pagëzuar këtë lëvizje për

prozelitizëm Dom Lush Gjergji). Prandaj edhe demokristianët e Bushatit përpiqen që politikisht ta identifikojnë islamizmin me dukurinë më të urryer tani nga shqiptarët, me komunizmin, të sajojnë “komunizmin islamik” në vend të sllavo-komunizmit nga i cili e ka pësuar Shqipëria

E vlen të përmend edhe një herë se Arso Milatoviç, ish diplomat jugosllav në Tiranë në vitet 1950, më 26 prill 1988 në “Borba” të Beogradit ka botuar artikullin “A i njohim shqiptarët?”, ku ndër të tjera ka theksuar: “Me dëshirën që të çlirohen nga pushteti i fqinjëve sllavë shqiptarët pranuan Islamin”. Arso Milatoviç urrejtjen për shqiptarët myslimanë nuk e ka patur më të vogël se Mark Bregu, por njeriu serioz nuk ia lejon vetes të thotë gjëra absurde për të cilat do ta qeshin. Prandaj nuk ka mashtruar si Mark Bregu lidhur me arsyet politike të pranimit të Islamit nga shqiptarët.

Diplomati italian Renco Falaski, në librin e Ismail Qemalit “**Memorie**” (botim italisht) ka bërë komentin e tij dhe ka cituar edhe autorin Rayer i cili ka mendimin se “nuk mund të mënjanohet hipoteza se konvertimi i grupeve shqiptare fillimisht në katolikë, pastaj në myslimanë u bë që të mos gllabëroheshin nga kultura helene”. Pra edhe këta e venë në dukje dukurinë e konvertimit vullnetar të një populli në fe tjetër për t'i shpëtuar asimilimit nëpërmjet një feje të përbashkët nga fqinjët. Kjo nuk është vetëm dukuri shqiptare. Ka ndodhur edhe më parë me kazarët, popullsi që kishin perandorinë e tyre në shekujt 9-11 midis Detit të Zi dhe Kaspik. Kazarët pranuan si fe judaizmin që të dalloheshin nga ortodoksia bizantine në Perëndim dhe myslimanizmi që depërtonte në Lindje, nga Kaukazi.

Në librin e Branimir Anzuloviçit “**Serbia qiellore, nga miti tek gjenocidi**” (botim i viteve të fundit) në pjesën me titull “*Takim me turqit. Perandoria Osmane*” shkruhet: “Perandoria Osmane sikurse Perandoria Arabe e Omajadëve që sundonte Spanjën, treguan një nivel të lartë tolerance fetare në krahasim me Bizantin ose vendet katolike që i dëbonte çifutët, Perandoria Osmane i pranonte dhe i la të qetë derisa ekzistoi” (fq. 33). Më tej në faqen 138 Anzuloviç shkruan : “Gjatë katër shekuj sundimi osman në Bosnje-Hercegovinë nuk pati luftra fetare ose civile, ndërsa disa luftra të tilla shkretuan pjesë të mëdha të Europës Perëndimore”.

Këtë që thotë Anzuloviç për Europën Perëndimore e konfirmon një personalitet i madh politik e akademik francez si Alen Peirefit, i cili në veprën e tij “**Le Mal Français**” (Sëmundja franceze), V.II, fq. 810 shkruan “Kasaphana më e llahtarshme, gjurmët e së cilës i mban ende kombi (francez) kanë qënë luftrat fetare, kjo gjakderdhje pasionante... Për të gjetur gjurmët e kësaj epoqe në shpirtin tonë të sotëm duhet të përfytyrosh si populli i vihej kësaj pune me gjithë forcat e tij. Marana një jezuite fanatike, ç'ka do të thotë se ishte e vëshirë të zbutej lehtë, e përshkruan kështu Shën Bartolomeun: disa u masakruan nga Mbreti, por më shumë nga populli. Plagoseshin, vriteshin kudo njerëz dhe më shpesh të pafajshmit, siç ndodh kur revoltohet populli”.

Nuk mund të gjendet tek asnjë autor, madje dhe tek më dashakeqi, dëshmi se myslimanizmi u bëri shqiptarëve, këtë që u bëri katolicizmi francezëve. Nuk mund të mospërfillësh atë që Peirefit shkruan edhe për Francën e sotme: “Intoleranca u bë e barazvlerëshme me Francën. (pas anulimit të ediktit të Nantes me të cilin Henriku u IV kishte kërkuar trajtim të barabartë të hugenotëve me katolikët). Ajo pastaj lulzoi me njëmijë forma. Ky manikeizëm fetar ka vazhduar deri në vitet 1960 në disa lugina të Francës ku katolikët dhe hugenotët nuk trazoheshin në të njëjtën listë bashkiake. Ata quhen “të bardhë”, “të kuq”, “të djathtë”, “të majtë”. Nuk blenin në të njëjtën shitore. Nuk përshëndeteshin kur këmbëheshin në trotuar,nuk dashuroheshin”.

Në Shqipëri nuk kanë ndodhur asnjëherë gjëra të tilla midis të krishterëve dhe myslimanëve.

Nuk duhet lënë vend të gjallojë fryma e Njegoshit në Shkodër

Edhe ajo që thotë Mark Bregu tani se disa shqiptarë morën malet “*të jetonin më mirë me ujkun se me turkun*” është një tërbim fanatik qëllimkeq i sotëm, është më tepër një frymëzim nga “**Kurora e Maleve**” e Njegoshit të Malit të Zi, se sa një shfryrje shqiptare.

Branimir Anzulović për të shpjeguar edhe nga këndvështrimi kulturor e psikologjik maninë serbo-sllave për mitet, e cila çon në etje për gjenocid, është marrë gjatë me analizën e kryeveprës së Njegoshit “**Kurora e Maleve**”. Ai ndalet posaçërisht në faktin se “**Kurora e Maleve**” e Njegoshit është e frymëzuar nga një masakër mbi myslimanët që në popull njihet si “*Vigjilja e Krishtlindjeve*”, ose si “*Zhdukja e turqve*” (sllavëve të islamizuar). Tema qëndrore e poemës është konflikti midis të krishterëve e myslimanëve malazezë që u zgjidh me masakrimin e myslimanëve”.

Tani vërejmë se 150 vjet pas “**Kurorës së maleve**” fryma e saj dhe e Njegoshit ripërtërihet në fanatizmin katolik të Partisë Demokristiane, “**Orës së Shqipërisë**” dhe njerëzve si Mark Bregu. “*Figuracioni folklorik*” i Mark Bregut “*më mirë me jetue me ujkun, e kurrë me turkun*”, është pikërisht fryma e “**Kurorës së Maleve**” që duan të fusin në Shqipëri fanatikët katolikë, francezë, italianë, kroatë, shqiptarë... Sllavo-komunizmi është sjellur ndaj shqiptarëve ashtu siç vjershëron Njegoshi për sjelljen e të krishterëve ndaj myslimanëve. Kurse Mark Bregu kërkon të shfajësojë sllavo-komunizmin dhe të shpikë një “*feudo-komunizëm islamik*” që meriton fatin e myslimanëve në poemën e Njegoshit.

Edhe çifti francez Shanse në librin “**Shqipëria , logjika e dëshpërimit**” vepron në frymën e tërbimit antiislamit dhe kërkon me çdo kusht të nxisë sherre fetare. Nuk mund të durojnë qytetarët e vendit të krishterë ku lufrat fetare kanë bërë kërdrinë që një vend i vogël si Shqipëria të jetë një kopësht i harmonisë fetare mes myslimanëve, katolikëve dhe ortodoksëve. Këta francezë duan me çdo kusht ta bëjnë Shqipërinë “*depo municioni të sherreve fetare*” që pastaj t'u japin nga një shkrepse djemve harrakatë si puna e Mark Bregut të ndezin fitilat.

Anzulović ka shpjeguar se krahas urrejtjes për Islamin dhe vajtimeve për shkatërrimin e Bizantit në “**Kurora e Maleve**” autori, Njegoshi, ka shpalosur edhe përçmim për Perëndimin katolik, duke bërë komente negative për Venedikun. Megjithatë “**Ora e Shqipërisë**” edhe këtë e kapërdin përderisa sllavo-komunizmin që është vijimësi e frymës së Njegoshit e fal për krimet kundër shqiptarëve.

Në librin e Anzulovićit gjejmë edhe një dëshmi shumë të hershme që hedh poshtë trillimet e “**Orës së Shqipërisë**” për Lindjen e prapambetur dhe Perëndimin e përparuar. Anzulović i referohet librit “**Kujtimet e një jeniçeri**” të shkruar nga serbi Konstantin Mihajlović, pjesmarrës në ushtrinë osmane që sulmoi Konstandinopojën më 1453. Ky u arratis dhe u vu në shërbim të mbretit katolik të Polonisë. Por në librin që shkroi pas arratisjes lavdëronte shumë tipare të shtetit e të sistemit osman, që sipas tij “*qëndronin më lart se sa kishte parë në vendet europiane*”, se “*osmanët silleshin mirë ndaj paganëve, të krishterëve dhe çifutëve*”.

Gazetarëve të “**Ora e Shqipërisë**” duhet t'u vijë shumë maraz që Faik Konica ka shkruar “*Tani e shohim t'udhës t'u japim një këshillë serbëve. Ata e dinë që ka 5 shekuj që shqiptarët kanë bërë aleancë me turqit vetëm e vetëm që të munden ta dërrmojnë soj sorrollopin e serbëve*” (Gazeta “**Urtia**” Tiranë, nr.5, gusht 1993). Nëse i besojnë këto fjalë të Konicës atëhere për cilët shqiptarë shkruan Mark Bregu se morën malet sipas motos “*më mirë me ujkun, por kurrë me turkun*”. Mos vallë e ka fjalën vetëm për një numër shqiptarësh që nën drejtimin e Gjergjit të Zi ikën bashkë me serbët e Arsenijes deri në Vojvodinë dhe prej Gjergjit të Zi serbët fituan dinastinë e Karagjorgjeviçëve? Për të përsëritur të tilla historira e duan luftën kundër “*komunizmit islamik*” gazetarët e “**Ora e Shqipërisë**”?!!!

Kam nguruar të përdor në polemikat e mëparshme disa citate që të tërheqin drejt teologjisë. Por në këtë polemikë ka vend t'i kujtoj Mark Bregut fjalët e Ali Khan (kryetar i “Qeverisë Islamike” shqiptare në mërgim, SHBA): “*Shqiptarët e përqaftuan Islamin sepse e panë si fe më të pastër e më të përparuar, më të afërt me Zotin, sikurse bënë bogumilet sllave për t'u*

mbrojtur nga inkuizicioni i krishterë, sikurse bënë albigenezët dhe katarët në Francë". Me këtë rast për Mark Bregun dhe të ngjashmit me të duhen përmendur edhe fjalët e Shën Jeronimit: *"Më e keqja është të jesh injorant për injorancën tënde"*.

Myslimanizimi ishte shpëtimtar, revanshizmi kundër tij është rrënimtar

Sido që të jetë zhvilluar procesi i myslimanizimit të shqiptarëve ky ka qënë një proces fatlum për të ardhmen e kombit shqiptar.

Fanatikët katolikë le të çirren e të ngjirren sa të duan për "anadollakët", "turkoshakët", "halldupët", "pushtimin", "robërinë", "robëruesit", "aziatikët". Myslimanizimi ka shpëtuar pjesët më të rëndësishme të kombit nga asimilimi, ka hedhur urat lidhëse atje ku rivaliteti ortodoksi-katolicizëm zgjeronte e thellonte hendeqet ndarëse midis shqiptarëve. Edhe sikur të jetë ashtu si pretendon Mark Bregu se myslimanizimin e paskan bërë osmanët me dhunë duhet t'i falenderojmë osmanët që për të mirën e shqiptarëve kanë bërë atë që duhej. Edhe tani ndodh në plot raste që janë disa të huaj që bëjnë, ose më shumë thonë, atë që duhet ta bëjnë e thonë shqiptarët për veten e tyre. Vatikanit, sllavëve, grekëve u është prishur qejfi. Por nuk është kjo që duhet të na preokupojë.

Në rast se ende disa fanatikë guxojnë të thonë se kanë qënë tradhëtarë ata që kanë ndërruar fenë, duhet t'u themi se tradhëtarë, sipas kësaj logjike dalin ata që nuk e ndërruan fenë, sepse nuk shkuan me shumicën për të mirën e përgjithshme. Atyre që guxojnë të thonë se myslimanët duhet të kthehen në fenë e të parëve, u duhet thënë se feja e të parëve është në radhë të parë ajo e nënës dhe e babait, pastaj e gjyshes dhe e gjyshit e kështu me radhë duke u larguar sa më shumë. Për kalimin në myslimanizëm nga çdo pikpamje shqiptarët duhet ta ndjejnë veten krenarë e jo mëkatarë si thotë Kadareja.

Ata që konkluzionet i nxjerrin vetëm duke u mbështetur në raporte priftërinjsh të kohës së rënies në plogështi e shthurjes së klerit katolik në trojet shqiptare le të bërtasin sa të duan se myslimanizimi qenka bërë me dhunë. Kliv Ponting na e ka sqaruar edhe këtë dukuri kur shkruan: *"Kur trajtohet historia e krishtërit është problem se të gjitha burimet vijnë nga brenda kishës, kështu çdo gjë tregohet nën dritën më të bukur dhe çdo gjë që dëmton kapërcehet"* (vepra e cituar fq. 276).

Mark Bregu me të ngjashmit e tij mund t'i fyejnë sa të duan myslimanët shqiptarë me ato epitetet e sajara nga urryesit e Islamit. Markut e të ngjashmëve të tij mund t'u duket se bëjnë trimëri të madhe kur i quajnë myslimanët "halldupë" meqënëse kështu paska thënë dikur Luigj Gurakuqi. Po se mos Luigj Gurakuqi vetë ka pak mëkate në fe, në politikë, në sjellje, në të folur? Vlerësimet për Gurakuqin nuk mund të mbeten vetëm në parametrat enveristë.

Sipas fjalorit të gjuhës shqipe fjala "halldup" paska kuptimin "pushtues osman", "tradhtar vendas", ose "njeri i pagdhëndur, i trashë nga mendja, njeri i keq".

Pushtues osmanë tani nuk ka. Tradhtarë vendas ka, por ata punojnë për grekët, sllavët, francezët, Vatikanin, italianët. Këta janë rreziku i Shqipërisë. Njerëz të pagdhëndur, të trashë, të këqinj sigurisht ka dhe jo pak. Puna është të zbulohen para opinionit publik se cilët janë. Prandaj po angazhohemi shpesh në polemikat të kësaj natyre.

Mark Bregu ende qenka tejet i zemëruar se osmanët detyruan paraardhësit e arbëreshëve të sotëm të shkojnë në Itali dhe këtë krim Marku nuk e fal dot. Duket që nuk ka lexuar libra fare, sepse përndryshe duhej ta dinte se shumica e arbëreshëve të Italisë kanë emigruar nga shqiptarët që ishin të vendosur më parë në Greqi. Stefan Dushani dhe sundimtarët serbë pushtuan Greqinë duke mobilizuar shqiptarë. Pastaj pati emigrim ekonomik siç ka dhe sot.

Për fatin e mirë të paditurit Mark Bregu i ka ardhur në ndihmë **"Gazeta Shqiptare"** e cila në suplementin e datës 5 qershor 2001 ka botuar shkrimin **"Arvanitët, si jetojnë në Greqi"**. Duke iu referuar një materiali të Komitetit të Helsinkit të Greqisë tregohet se emigrimet e shqiptarëve në Greqinë qëndrore e jugore e Peloponez kanë ndodhur qysh në shekullin e XI-XII dhe se në kohën kur Greqia u pushtua nga turqit 45% e popullsisë ishte

shqiptare. Në vitin 1991 në një seminar ndërkombëtar në Rodos kam takuar një gazetare greke që fliste shqipe arkaike, e cila më tha se paraardhësit e saj kishin emigruar para 700 vitesh. Në **“Gazeta Shqiptare”** të datës 5.6.2001 shkruhet se Athina ishte qyteti i vogël shqiptar para se të bëhej kryeqyteti i Greqisë.

Shumë nga shqiptarët e Greqisë, sidomos të Moresë (Peloponezit) kaluan në Apenine. Edhe tani kënga e tyre nostalgjike është **“Moj e bukura More”**, jo **“Moj e bukura Arbëri”**. Mark Bregu me shokë bëjnë mirë të mos harrojnë se në Turqi ka miliona njerëz me origjinë shqiptare, se Turqia u bë një atdhe i dytë për shqiptarët e dëbuar në kohë të ndryshme nga sllavët e grekët, nga Tregu i Ri, Kosova, Prokupla, Kurshumlija, Shqipëria Lindore, Kosturi, Follorina, Çamëria. Askund shqiptarët nuk janë integruar më mirë dhe më me dobi për kombin shqiptar e Shqipërinë se në Turqi, madje edhe pjesërisht të asimiluar pa dhimbjen që shkakton asimilimi. Kjo i vëllazëron edhe sot shqiptarët me turqit më shumë se me çdo popull tjetër. Fanatikëve katolikë kjo nuk u pëlqen. Le ta përmbysin këtë proces po të jenë të zotët. Detyra jonë është vetëm t'u themi të mos merren me donkishotizma të revanshizmit fetar, etnik, etnologjik.

Katolikët të mos gjykojnë sipas klerikalizmit të katolikocentristëve

Klerikët dhe besimtarët katolikë që të dëshmojnë bindshëm për të tjerët ndiesitë e tyre kombëtare nuk duhet të shkasin në qëndrime të atilla që studiuesi Injac Zamputi i ka cilësuar si *“aksin përçmues e denigrues ndaj shqiptarëve në terrenin kishtar katolik nga kleri i lartë sllav, i cili kishte siguruar në Shqipëri disa qeli dioqezore e abaciale”* (Eskursion në dy vepra të Kadaresë, fq.27).

Kur kam polemizuar me Dom Ndoc Nogën para një viti i jam referuar edhe studimit të historianit nga Kosova Sadulla Brestovci mbi marrëdhëniet shqiptaro-malazeze ku ai bën fjalë për disa priftërinj katolikë në Shqipërinë e Veriut që vepronin si agentë të sllavëve. Më bën përshtypje edhe një reagim i Preng Gjergjit më 17 maj 2001, nëpërmjet shkrimit *“Mirdita dhe Pal Doçi e njohin krejt pak njëri-tjetrin”*, për kundër mendimit të shprehur nga Pali në librin **“Vatër e qëndresës antiosmane”** se Kleri katolik ishte kundër kryengritjes kombëtare shqiptare dhe gjithmonë vepronte në dëm të çështjes. Nuk është punë e imja tani të mbështes, apo ta kundërshtoj qortimin e ashpër të Preng Gjergjit se *“të akuzosh klerin katolik për antishqiptarizëm do të thotë ta radhitësh atë në krah të pushtuesve osmanë, ç'ka është mëkat dhe hipokrizi”*. Por në librin e Pal Doçit ka (më pak se në librin e Sadulla Brestovcit) fakte e dëshmi edhe për qëndrime jo atdhetare të klerit katolik, apo për bashkëpunim të këtij kleri me Malin e Zi, për të cilin më në fund, sikurse pohon Pal Doçi, edhe mirditorët u bindën se i përkrahte autonominë e kryengritjet e tyre kundër Turqisë vetëm që të shtinte në dorë troje shqiptare.

Por kemi një fakt tjetër se nuk janë vetëm *“fundamentalistët islamikë”* që hedhin për diskutim rolin e pozicionet e klerit katolik ndaj çështjes kombëtare. Për t'u shmangur nga gjykimet e njëanshme e të gabuara duhet të mbajmë parasysh një element themelor: Kleri Katolik nuk duhet marrë si një organizëm e mekanizëm unik, por duhen dalluar edhe prirjet e krahët e ndryshëm që kanë ekzistuar brënda tij. Për këtë na kanë tërhequr vemendjen me kohë politikanë, historianë që i kanë njohur mirë problemet dhe nuk na bie ndonjë barrë e rëndë të zbulojnë të fshehtat.

Për rolin antishqiptar të klerikëve katolikë sllavë, siç u përmend, kanë shkruar Injac Zamputi e Sadulla Brestovci. Për rolin antishqiptar të priftërinjve katolikë italianë si Kordinjano kanë shkruar Dom Nikoll Mazreku, Dom Ndre Zadeja, profesorët e Liceut Shtetnuer të Shkodrës para 60 vitesh. Nikoll Ivanaj, Hil Mosi kanë shkruar për rolin e dëmshëm politik të një pjese të klerit katolik dhe politikanëve katolikë, që Nikolla i pagëzonte edhe si *“Internacionalja e Zezë”*. Është shkruar për rolin e disa klerikëve e politikanëve katolikë në krijimin e *“Republikës së Mirditës”* (1921) apo *“Kryengritjes së Dukagjinit”* (1926) që minonin shtetin shqiptar që sapo kishte filluar të ngrihej në këmbë. Madje vetë kleri katolik në Shkodër ka

dënuar priftërinjtë që shkonin në Lidhjen e Kombeve të kërkonin njohjen e “Republikës së Mirditës”, sipas planeve të Beogradit.

Në përmbledhjet e dokumentave të Lidhjes së Kombeve ka edhe protesta të disa krerëve e banorëve të Mirditës kundër njohjes së republikës që kishte shpallur Marka Gjoni nën tutelën e Serbisë. Diplomati shqiptar Dhimitër Berati, vllah ortodoks dhe jo ndonjë “*bej mysliman*” apo “*komunist islamik*”, në librin e tij për Lidhjen e Kombeve dhe për pranimin e Shqipërisë në të, shpreh edhe neverinë që i shkaktoi paraqitja e një prifti katolik shqiptar në Asamblenë e Lidhjes si “*Ministri i Arsimit i Qeverisë së Republikës Katolike të Mirditës*”.

Mehdi Frashëri në librin “*Historia e Lashtë e Shqipërisë....*” (fq.35) ka shënuar se “*...kisha katolike parapëlqeu monarkinë me një mbret katolik*”. Historiani Stavro Skëndi në “**Zgjidhjen kombëtar të shqiptarëve**” (fq.162) shkruan: “*Monsinjon Prend Doçi më aktiv dhe më i mençuri politikisht që shpiku alfabetin “Bashimi” i emëruar prift në Mirditë më 1875 u përzie me kryengritjen e asaj krahine kundër turqve më 1877, u dërgua syrgjyn në Stamboll, bëri mision të shumta për Vatikanin dhe u kthye Abat në Mirditë më 1888.*” Sipas Stavro Skëndit, Abati Doçi mbante lidhje të ngushta me austro-hungarezët dhe ashtu si Sami Frashëri mendonte për bashkimin e shqiptarëve që t’u kundërviheshin fqinjëve e për autonomi nën Turqinë”. Pra Skendi e vendos Prend Doçin në atë krah të klerit katolik që anonte nga Austro-Hungaria, mikja më e mirë e shqiptarëve, jo nga krahu tjetër që anonte nga sllavët e italianët. Por Pal Doçi në librin e tij të përmend shumë raste kur Prend Doçi shkante e vinte edhe në Mal të Zi për bashkëpunim.

Duhet të marrin fund atavizmat për kantonizim të bazuar në dallime fetare

Stavro Skëndi shkruan se “*mendimet e Prend Doçit ishin “regjionale dhe katolike”. Besa që ai përkrahte kufizohej në Veri dhe kishte si detyrë të parë krijimin e një principate katolike*”. Skëndi mendonte se Prend Doçi ishte për një shtet shqiptar me bërthamë katolike e kryeqendër Shkodrën duke siguruar ndikimin e Austro-Hungarisë. Edhe Pal Doçi e konfirmon në librin e tij një gjë të tillë, pavarësisht se është munduar që tërë lëvizjet për autonomi e pavarësi të Mirditës t’i vendosë në kuadër të një ndërgjegje mbarë kombëtare. Kjo e shkretë ide për “*principatën katolike*” duket se edhe sot pas një shekulli nuk shkulet nga mendja e disave, madje po merr edhe karakter e përmasa të politikës fetare, partiake e pushtetore të ditës.

Nuk ka si të kalojë pa u vënë re që në shtypin e Tiranës, gazetën “**Albania**” të datës 19 qershor 2001 reportazhi mbi pjesëmarrjen e kryetarit të PS, Fatos Nano dhe të kryeministrit, Ilir Meta, në mitingun e Lezhës për të mbështetur kandidaturën e Nikoll Lesit është botuar nën titullin “**Lezha, kryeqendra e Veriut**” dhe Nikoll Lesi këtë e trumbetoi si premtimin e tij më të madh për zgjedhësit. Mënyra si u krijua prefektura e Lezhës, si Kurbini u shkëput nga rrethi i Krujës, nuk u ngjit më me të në një prefekturë, por kapërceu lumin për t’u lidhur me Lezhën janë dëshmi e prirjeve për të krijuar një njësi sa më të gjerë administrative duke patur si kriter bazë përkatësinë e njerëzve në fenë katolike.

Këto mendësi e nxjerrin kokën për sherr edhe atje ku nuk ka vend e arsye për të krijuar diskutime të kësaj natyre. Këto gjëra nuk sajohen e eksperimentohen për herë të parë. Kur lexon librin e Pal Doçit vëren se gjithnjë shkak fërkimesh me “*hyqymetin*” osman ka qenë edhe synimi i këtij “*hyqymeti*” për të mos bashkuar administrativisht 12 bajrakët e Mirditës. Por tani në kohën e “*hyqymetit*” europian shqiptar, nuk duhet ta ndiejmë më veten si në kohën e “*12 bajrakëve*”, të “*9 maleve*” (të Dibrës), apo të “*Zonës së parë operative*” (Vlorë-Gjirokastrë); nuk duhet të ketë vend lokalizma të ngushtë në ndarjen administrative dhe aq më tepër për krijim njësishtë mbi baza fetare katolike.

Njëri nga gazetarët e “**Orës së Shqipërisë**”, Ndue Bushkolla, ka botuar në gazetën “**55**” dhe ribotuar në “**Ora e Shqipërisë**” (1 qershor 2001) shkrimin me titull “**Udhëtim nëpër terr e shkreti buzë liqeneve të dritës**”. Ai përmend jashtë kontekstit normal të shkrimit se përgjatë bregut të liqenit artificial të Ulzës, janë fshatrat Bushkash, Stojan, Karicë, Bazë, Rreth

- Bazë që përbëjnë “*bajrakun e Rrazës*”, njërin nga 12 bajraqt e dikurshëm të Mirditës, ndonëse bënte pjesë në sanxhakun e Ohrit. Dhe “*papritmas*” lëshon psherëtimën mallkuese: “*Dhe këtu diktatura komuniste u tregua e pamëshirshme duke i ndarë këto fshatra nga Mirdita dhe duke i lënë në rrethin e Matit*”. Një psherëtimë sikur këto fshatra ku banojnë më shumë katolikë të kishin mbetur jashtë kufijve shtetërorë, në ndonjë shtet të huaj, jo me shqiptarët myslimanë të Matit.

Në fakt këto fshatra nga Mirdita i ndan liqeni artificial i hidrocentralit dhe malet e kodrat, kurse me qendrën e rrethit të Matit i lidh afërsia, i lidh rruga automobilistike, i lidhin lehtësirat për gjithçka. Diktatura komuniste nuk u ka bërë ndonjë padrejtësi, por vetëm u ka krijuar lehtësira banorëve të kësaj ane duke i lidhur me administratën në Burrel e jo në Rrëshen. Këtë besoj e kupton edhe lëshuesi i psherëtimës. Por tani është gjetur një mënyrë e lehtë për të përligjur edhe ankesat më absurde duke i shoqëruar me ndonjë mallkim për diktaturën komuniste.

Diktatura komuniste nuk u vuri asnjë kufizim të posaçëm banorëve të këtyre fshatrave për çfarëdo lloj kontakti me Mirditën. Në ankesën e Bushkolës është fryma që kufijtë e njësive administrative katolike duhet të shkrihen deri atje ku ka një fshat me popullsi katolike. Do të ishte një marrëzi të mos lidheshin administrativisht me Mirditën (si rreth) e Lezhën (si prefekturë) këto fshatra nëse banorët e tyre e dëshirojnë këtë gjë, në një kohë kur në Shqipëri ka plasur mania për lloj - lloj ndryshimesh në ndarjet administrative për kapriço lokaliste e pa kurrfarë dobie. Por nëse banorët e “*fshatrave katolikë*” të Matit mysliman nuk ia kanë kërkuar Bushkolës ta shtrojë këtë çështje në shtyp, ky vepron gabim që bën pickime të tilla.

Në Shqipërinë e Jugut popullsia e krishterë, ortodokse, është në një përqindje më të madhe se ajo katolike në Shqipërinë e Veriut. Fatmirësisht tek ortodoksët në Jug nuk vihen re prirje të tilla për krijim njësisht administrative në bazë të fesë. Këtë herë pas here e kërkojnë vetëm minoritarët grekofonë. Kështu që përpjekja e disa mjediseve katolike në Veri, për njësi administrative mbi bazë fetare janë inkurajim për grekofonët e Jugut e pastaj mund të inkurajojnë edhe “*minoritetet*” e tjera.

Katolikocentristët i shërbejnë spekulimit me “pakicat e krishtera” të Shqipërisë

Përpjekjet për ta shndërruar Shqipërinë në një mozaik minoritetesh etnike, gjuhësore e fetare, për ta shndërruar shtetin shqiptar kombëtar në një shoqëri multietnike janë të njohura qysh herët, por tani po marrin përmasa më kërcënuese.

Më 5 qershor 2001 në gazetën “**Tema**” është botuar shkrimi “**Respektimi i pakicave kusht për një shoqëri të lirë**” ku u bëhet jehonë tezave që shtroi Sali Berisha në mitingun në Gjirokastrë për mbrojtjen e minoritetit në Shqipëri, sipas formulës së tij ultraparimore “**Origjina dhe besimi i njeriut janë baza e lirisë së individit**”. E keqja e këtij hapi në radhë të parë qëndron në faktin se ai hidhet në një kontekst shumë të rrezikshëm politik për Shqipërinë.

Analisti Mehmet Elezi, që u bën shpesh jehonë qëndrimeve e pikëpamjeve të Berishës, më 29 maj ka botuar në simotrën **PëDëiste** të “**Temës**”, në gazetën “**55**” shkrimin “**Strategjia e gogolizimit të shqiptarëve**” ku ai me të drejtë tërheq vemendjen e opinionit publik shqiptar mbi një propozim djallëzor të Nikolas Geixh bërë nëpërmjet “**Uashington Post**” në SHBA. Geixh kërkuaka mbajtjen e një konference ndërkombëtare për minoritetet në Ballkan me qëllim që “*minoriteteve fetare*”, pra bashkësive ortodokse e katolike, të Shqipërisë t’u sigurohen ato të drejtat që kërkohen për shqiptarët në Kosovë, d.m.th. deri shkëputje nga Shqipëria, meqenëse për shqiptarët e Kosovës tani kërkohet jo më pak se pavarësia.

Geixh nëpërmjet krijimit të problemit të “*pakicave të krishtera në Shqipëri*” ringjall planet e vjetra të Beogradit, të Athinës për shpërbërjen e shtetit shqiptar. Nga kjo kuptohet lehtë sa të rrezikshme dhe të dëmshme janë idetë e veprimet për të krijuar veçanësi politike, partiake, administrative mbi baza fetare, sikurse po përpiqen disa mjedise klerikaliste e politike katolike nëpërmjet Partisë fetare Demokristiane.

Këshilla nga të ditur për nevojtarë të paditur

Në mbyllje të këtij shkrimi çmoj se duhet përsëritur se është një marrëzi të shpikësh një “komunizëm islamik shqiptar” për të shfaqësuar sllavo-komunizmin që ka qenë e mbetet fatkeqësia më e madhe historike e shqiptarëve. Prandaj Mark Bregu dhe kalemxhinjt e demokristianëve mbase mund të ndihmohen më mirë duke u kujtuar fjalët e Didëroit : “*Është më e vështirë të jeshë i madh në marrëzi se në talent e në virtyt*”. Kurse talentin e virtytin e tyre Marku me shokë le ta tregojnë mbasi të kenë ngulitur mirë në kokë thënien e Gëtes : “*Më e arsyeshme është që secili të bëjë punën e vet për të cilën është lindur dhe ka mësuar dhe të mos pengojë të tjerët të bëjnë të njëjtën gjë. Këpuctari të merret me këpucët, bujku të lërojë arat e Princi të mësojë të qeverisë, se dhe qeverisja është një zanat që duhet mësuar*”.

Ndoshta edhe njerëzit që bëjnë “teorira të mëdha” në “**Ora e Shqipërisë**” pa e patur zanatin për to ndonjë ditë do të mençurohen dhe të bëjnë atë që u takon.